

Kumbona e së Diellës

Kryqi në Dajç të Zadrimës në nder të Gazullorëve



Skulptor: Sadik Spahia

NJË JUBILE I VEÇANTË I SKALITUR NË TOKËN ABNORE

Fjala përshëndetëse me rastin e përvjetorit 25 vjetorit ipeshkvor të Mons. Angelo Massafra Shkodër, 9 janar 2022

*I nderuar Shkëlqesi mons Angelo Massafra
I nderuar Shkëlqesi Nunci Apostolik Luigji Bonazi
Të nderuar ipeshkvij të pranishëm
Të dashur bashkë-vëllezër ne meshtari dhe të dashur vllazën e motra.*

Shkëlqesi i nderuar Mons. Angelo, kam kënaqësinë t'ju përcjelli urimet e përzemerta në emër tim personal të mbar klerit dhe të besimtarëve.

Për ty sot është një jubile i veçant i skalitur në tokën abnore nëpër dallgët dhe vështërsit e jetës. Nuk mund të rri pa të kujtuar Miriditën e martirizuar që e ke dashur dhe e do shumë; Lezhën e besëlidhjes ku filloj formimi i besimtarëve; Sapën e historisë ku zbulove rrënjët e kishës shqiptare dhe së fundmi Shkodrën e dëshmisë ku e ngrite në pedestal, flijimin e martirëve duke e shpallur fitoren e Krishtit Mbret.

I nderuar Shkëlqesi, më lejoni t'ju kujtoj udhëtimin tënd neper vite rimëkëmbjen e Kishave nga e para të shoqëruar nga vizitat e ndryshme baritore neper malet dhe fshatrave të dioqezës ku preke më dorën tënde realitetin dhe veshitë të grigjës që të është besuar.

Në vitin e tragjedisë së marsit të 1997 me mençuri ditur më i prirë grigjës së Tenzot.

Në mars të vitit 1999 mikëpritja e bashkëvëllezërve tanë të ardhur nga Kosova të udhëhequr nën drejtimin tënd, kemi dëshmuar bujarin shqiptare.


Festimi i vitit jubilar 2000 dhe shukurimi i meshtarve të parë të formuar në seminar mbas komunizmit ishin vepër e përkujdesit të tuaj atërore. Me përkushtimin tëndë i dhe një hov ringritjes së Kishës Katolike në Shqipëri, më botimin e dokumenteve të Kishës për edukimin e besimtarëve, hapjen e procesit dioqezan për Lumnimin martirëve më 10 nëntor të viti 2002, dhe pikërisht këtu në Katedrale u lartësuan në përjetësi, më 5 nëntor 2016, duke u shpallur të Lum 38 Martir dhe shumë momente të tjera.

Nuk me mbetet gjë tjetër vetëm që të ju falënderojmë për përshkushtimin dhe sakrificat e shumta të bëra për gjatë këtyre viteve dhe lusim Zojën e Shkodrës, Nanën e Këshillit të Mirë, Nënë Terezen dhe Martiret e Lum që të ndërmjetësojnë para Atit të Gjithëpushtetshëm për të ju dhuruar hirit që në Emër të Tij t' vazhdash të shkëlqesh si drita e yllit të mëngjesit që lajmëron Agimin e Ri.

**Dom Nikolin Toma,
Vikar gjeneral**



*Takimi me Papa Françeskun
6 janar 2022 - Romë*





Papa Françesku TË VIHEMI PRANË ATYRE QË VUAJNË	4
Imzot Angelo Massafra OFM 25 VJETORI I SHUGURIMIT IPESHKVNOR	6
Dom Dritan Ndoci KRESHMET, KOHË RRRITJEJE	8
Dom Nosh Gjollaj KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES	9
Motër Marjeta Gjoka JETA E KUSHTUAR NË KISHË	11
Redaksia TRADITAT FETARE DHE ATDHETARE	15
Imzot Angelo Massafra OFM TË SHIKOHET DINJITETI NJERËZORE	17
Kisha.al 1859 - HISTORIA E SEMINARIT	18
Dom Nikë Ukgjini FISHTA NDËRMJET STUDIMEVE	19
Don Emilio Valente TË KRISHTERËT THIRREN	21
Imzot Angelo Massafra OFM PAPA FRANÇESKU FLET PËR DIALOGUN	24
Redaksia KISHA KATOLIKE ITALIANE	25
Fra Lorenc Pepniku DETYRA E DIAKONIT ËSHTË SHËRBIMI	26
Dom Vlash Palaj NDAHET NGA JETA DOM GJERGJ SIMONI	27
Motër, Terezina Demaj NJË JETË ME DINJITET	29
Redaksia ROLI I GAZULLORËVE	31

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXV, nr. 1/2 (551 - 552) Janar - Shkurt 2022

Revistë Fetaro-Kulturore

Drejtues

Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia:

Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)

Dom Vlash Palaj

Dom Gjovalin Simoni

Xhon Nika (Redaktor Teknik)

Adresa:

Araqipeshkvia Shkodër

Sheshi Gjon Pali II

Tel. 0222-42764 / Fax. 0222-43673

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

www.kishakatolikeshkoder.com

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT



TË VIHEMI PRANË ATYRE QË VUAJNË, NË NJË ECJE DASHURIE!

Mesazhi i Atit Shenjtë Françeskut
Për ditën e XXX Botërore të të sëmurit
Romë, 10 dhjetor 2021

«Bëhuni edhe ju të mëshirshëm, sikurse edhe Ati juaj është i mëshirshëm» (Lk 6,36).

Të dashur vëllezër dhe motra, tridhjetë vjet më parë, Shën Gjon Pali II themeloi Ditën Botërore të të Sëmurit për të sensibilizuar popullin e Hyjit, institucionet shëndetësore katolike dhe shoqërinë civile kundrejt vëmendjes ndaj të sëmurëve dhe atyre që kujdesen për ta.

Ne i jemi mirënjohës Zotit për ecurinë e viteve të fundit në Kishat vendore të mbarë botës. Janë bërë shumë hapa përpara, por ka ende shumë rrugë për të bërë për t'u siguruar të gjithë të sëmurëve, edhe në vendet dhe situatat e varfërisë dhe mënjanimit më të madh, kurat shëndetësore që u nevojiten; si dhe shoqërimin baritor, që të mund ta jetojnë kohën e sëmundjes të bashkuar me Krishtin e kryqëzuar dhe të ngjallur. Dita e 30-të Botërore e të Sëmurit, krentimi kulmor i së cilës nuk mund të zhvillohet në *Arequipa* në Peru, për shkak të pandemisë, por do të mbahet në Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, na ndihmoftë që të rritemi për nga afërsia dhe shërbimi ndaj të sëmurëve dhe familjeve të tyre.

1. Të mëshirshëm si Ati

Tema e zgjedhur për këtë ditë të tridhjetë, «Bëhuni edhe ju të mëshirshëm, sikurse edhe Ati juaj është i mëshirshëm» (Lk 6,36), më së pari na bën t'i drejtojmë sytë nga Hyji "i pasur me mëshirë" (Ef 2,4), i cili i shikon gjithmonë fëmijët e tij me dashurinë e atit, edhe kur largohen prej Tij. Njëmend, mëshira është vetë emri i Hyjit, i cili e shpreh natyrën e tij jo në mënyrën e një

ndjenje të rastit, por si forcë e pranishme në gjithçka që Ai kryen. Është forcë dhe butësi së bashku. Për këtë gjë mund të themi, me mahnitje dhe mirënjohje, se mëshira e Hyjit ka në vetvete edhe përmasën e atësisë edhe atë të amësisë (krh. Is 49,15), sepse Ai kujdeset për ne me forcën e një ati dhe me butësinë e një nëne, gjithmonë i etur për të na dhënë jetë të re në Shpirtin Shenjt.

2. Jezusi, mëshira e Atit

Dëshmia më e madhe e dashurisë së mëshirshme të Atit kundrejt të sëmurëve është Biri i tij i njëlindur. Sa herë Ungjijtë na tregojnë për takimet e Jezusit me njerëz të prekur nga sëmundje të ndryshme! Ai «shkonte prej një vendi në një vend tjetër nëpër mbarë Galilenë, duke mësuar në sinagogat e tyre, duke predikuar Ungjillin e Mbretërisë e duke shëruar në popull çdo sëmundje e çdo pamundësi» (Mt 4,23). Mund të pyesim veten: pse kjo vëmendje e veçantë e Jezusit ndaj të sëmurëve, deri në atë pikë sa bëhet edhe vepra kryesore në misionin e apostujve, të dërguar nga Mësuesi për të kumtuar Ungjillin dhe për të shëruar të sëmurët? (krh Lk 9,2).

Një mendimtar i shekullit XX na sjell ndërmend një motivim: «Dhimbja të izolon në mënyrë absolute dhe pikërisht nga ky izolim absolut lind apeli ndaj tjetrit, thërritja ndaj tjetrit». Kur një person përjeton dobësi dhe vuajtje në mishin e tij për shkak të sëmundjes, rëndohet edhe zemra e tij, frika rritet, pyetjet shumëfishohen, kërkesa për kuptim në lidhje me gjithçka që ndodh bëhet më e ngutshme. Si të mos i

kujtojmë, në këtë drejtim, të sëmurët e shumtë, të cilët gjatë kësaj kohe të pandemisë e jetuan pjesën e fundit të ekzistencës së tyre në vetminë e një reparti të terapisë intensive, sigurisht të kujdesur nga punonjës shëndetësorë bujarë, por larg nga ngrohtësia e më të dashurve dhe nga njerëzit më të rëndësishëm të jetës së tyre tokësore? Ja, atëherë, rëndësia e pasjes pranë dëshmitarëve të dashurisë hyjnore, të cilët, duke ndjekur shembullin e Jezusit, mëshirë e Atit, derdhin mbi plagët e të sëmurëve vajin e ngushëllimit dhe verën e shpresës.





3. Ta prekim mishin e vuajtur të Krishtit

Ftesa e Jezusit për të qenë të mëshirshëm si Ati, merr një domethënie të veçantë për punonjësit shëndetësorë. Mendoj për mjekët, infermierët, teknikët e laboratorit, të ngarkuarit për shërbim dhe kurim të të sëmurëve, si dhe vullnetarët e shumtë që dhurojnë kohë të çmuar për ata që vuajnë. Të dashur punonjës shëndetësorë, shërbimi juaj pranë të sëmurëve, i kryer me dashuri dhe kompetencë, i kapërcen kufijtë e profesionit për t'u bërë kështu një mision. Duart tuaja që prekin mishin e vuajtur të Krishtit mund të jenë një shenjë e duarve të mëshirshme të Atit. Jini të vetëdijshëm për dinjitetin e madh të profesionit tuaj, si dhe për përgjegjësinë që ai bashkëmbart.

Ne e bekojmë Zotin për përparimin që shkenca mjekësore ka bërë veçanërisht kohët e fundit; teknologjitë e reja kanë bërë të mundur përgatitjen e programeve terapeutike që sjellin dobi të madhe për të sëmurët; kërkimi vazhdon të japë kontributin e vet të vyer në mposhtjen e patologjive të vjetra dhe të reja; mjekësia rehabilituese ka zhvilluar ndjeshëm njohuritë dhe kompetencat e saj. Mirëpo, e gjithë kjo nuk duhet të na bëjë askurrë të harrojmë veçantinë e çdo të sëmuri, me dinjitetin dhe dobësitë e tij. I sëmuri është gjithmonë më i rëndësishëm se sëmundja e tij dhe për këtë arsye asnjë qasje terapeutike nuk mund ta anashkalojë dëgjimin e pacientit, historinë e tij, ankthet, frikësimet e tij. Edhe kur nuk është e mundur të shërosh, është gjithmonë e mundur të kurosh, është gjithmonë e mundur të bësh që njerëzit ta ndiejnë një afërsi që tregon më shumë interes për personin sesa për patologjinë e tij. Për këtë arsye, uroj që rrugëtimet formuese të punonjësve shëndetësorë të jenë në gjendje që të aftësojnë për dëgjim dhe për dimensionin e marrëdhënies.

4. Vendet e kurimit, shtëpi të mëshirës

Dita Botërore e të Sëmurit është gjithashtu një rast i përshtatshëm për ta përqendruar vëmendjen tonë mbi vendet e kurimit. Mëshira kundrejt të sëmurëve e ka shtyrë bashkësinë e krishterë gjatë shekujve që të hapë pafund “bujtina të samaritanit të mirë” ku të mund të mirëpritëshin dhe kuroheshin të sëmurët e çdo lloji, veçanërisht ata që nuk gjenin përgjigje për kërkesën e tyre shëndetësore ose për shkak të varfërisë ose të përjashtimit social apo për arsye të vështirësive të kurimit të disa patologjive. Në këto situata, ata që e paguajnë janë sidomos fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit më të brishtë. Shumë misionarë, të mëshirshëm si Ati, e shoqëruan kumtimin e Ungjillit me ndërtimin e spitaleve, dispanserive dhe vendeve të kurimit. Janë vepra të çmuara nëpërmjet të cilave ka marrë formë bamirësia e krishterë dhe, dashuria e Krishtit, e dëshmuar nga dishepujt e tij, është bërë më e besueshme. Mendoj mbi të gjitha për popullsitë e zonave më të varfra të planetit, ku ndonjëherë është e nevojshme të bëhen udhëtime të gjata për të gjetur qendra kurimi, të cilat, megjithëse me burime të

kufizuara, ofrojnë atë që është e disponueshme. Ka ende shumë rrugë për të bërë dhe në disa vende marrja e kurimit të përshtatshëm mbetet një luks. Kjo dëshmohet, për shembull, nga disponueshmëria e pakët, në vendet më të varfra, e vaksinave kundër Covid-19; por akoma më shumë mungesa e kurimit të patologjive që kërkojnë ilaçe shumë më të thjeshta.

Në këtë kontekst, dëshiroj të ripohoj rëndësinë e institucioneve shëndetësore katolike: ato janë një visar i çmuar për t'u ruajtur dhe mbështetur; prania e tyre ka shënuar historinë e Kishës për afërsinë e saj ndaj të sëmurëve më të varfër dhe ndaj situatave më të lëna pas dore. Sa shumë themelues të familjeve rregulltare kanë ditur të dëgjojnë britmat e vëllezërve dhe motrave të cilët nuk e kishin mundësinë e qasjes ndaj kurave ose kuroheshin keqas dhe kanë bërë të pamundurën në shërbim të tyre! Ende sot, edhe në vendet më të zhvilluara, prania e tyre është një bekim, sepse përveç kurimit të trupit me gjithë kompetencën e nevojshme, mund të ofrojnë gjithmonë atë dashuri falë të cilës i sëmuri dhe familjarët e tyre janë në qendër të vëmendjes. Në një kohë në të cilën kultura e skartimit është e përhapur dhe jeta nuk njihet gjithmonë si e denjë për t'u pranuar dhe jetuar, këto struktura, si shtëpi të mëshirës, mund të jenë shembullore në mbrojtjen dhe kurimin e çdo ekzistencë, edhe të më të brishtës, që nga fillimi deri në mbarimin e saj natyror.

5. Mëshira baritore: prani dhe afërsi

Në rrugëtimin e këtyre tridhjetë viteve, edhe baritorja e shëndetit ka parë të njohur gjithnjë e më shumë shërbimin e saj të domosdoshëm. Nëse diskriminimi më i keq që vuhet nga të varfrit – dhe të sëmurët janë të varfër për nga shëndeti – është mungesa e vëmendjes shpirtërore, ne nuk mund të mos u ofrojmë atyre afërsinë e Hyjit, bekimin e tij, Fjalën e tij, kremtimin e Sakramenteve dhe propozimin e një ecjeje për t'u rritur dhe pjekur në fe. Në lidhje me këtë gjë, dua t'ju kujtoj se afërsia ndaj të sëmurëve dhe kujdesi baritor kundrejt tyre nuk është detyrë vetëm e disa mbarështuesve të përkushtuar në mënyrë specifike; Krishti u ka drejtuar të gjithë dishepujtë të tij ftesën për të vizituar të sëmurët. Sa të sëmurë dhe sa të moshuar jetojnë në shtëpi dhe presin një vizitë! Shërbesa e ngushëllimit është detyrë e çdo të pagëzuarit që kujtohet për fjalën e Jezusit: «Isha i sëmurë e erdhët të më shihni» (Mt 25,36).

Të nderuar vëllezër dhe motra, ia besoj ndërmjetësimit të Marisë, shëndeti i të sëmurëve, të gjithë të sëmurët dhe familjet e tyre. Të bashkuar me Krishtin, që mbart mbi vete dhimbjen e botës, gjetshin kuptim, ngushëllim dhe besim. Lutem për të gjithë punonjësit shëndetësorë në mënyrë që, të pasur me mëshirë, t'u ofrojnë pacientëve, së bashku me kurat e nevojshme, afërsinë e tyre vëllazërore.

Përzemërsisht u jap të gjithëve Bekimin tim Apostolik.



NË 25 VJET JAM KUJDESUR PËR KËTË KISHË TË VEÇANTË, POR EDHE PËR KISHËN UNIVERSALE

Homelia për 25 vjetori te shugurimit ipeshkvnore
Imzot Angelo Massafra OFM
Shkodër, 9 janar 2022

*Shumë të dashur vëllezër në ipeshkvni,
I dashur Imzot Asti, e Kishes Ortodokse
meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare
dhe të dashur Vëllezër dhe Motra*

Sot kremtojmë misterin e ujit dhe të Shpirtit përmes të cilit, në përngjasim me Krishtin, të gjithë ne bëjmë daljen tonë pashkore, kaluam ujërat (shkak vdekjeje për mëkatin, por burim jete për shpëtimin) dhe dolëm në hir.

Kështu na tha Shën Pali: "*Vërtet u duk hiri i Hyjit që u sjell shëlbimin të gjithë njerëzve*" (Tit 2,11). Fjala që na jep hir, që na liron nga dënimi i merituar për fajet tona, është ai Jezus të cilin e soditëm vetëm pak ditë më parë në misterin e lindjes së tij, me të cilin u bashkuam nëpërmjet pjesëmarrjes në sakramente dhe në të cilin sot sodisim rilindjen tonë.

Ai i pari, së bashku me krejt Trininë e Shenjtë, zbrit në ujërat e Jordanit për të kryer ritin e pastrimit dhe, në këtë mënyrë, për t'u solidarizuar me gjininë njerëzore, me atë natyrë që ka dashur të marrë për ta bërë krejt të re atë dhe për t'i rikthyer pafajësinë e saj fillestare; solidaritet që, menjëherë pas kësaj, do ta përtërijë duke e lënë veten që të shkojë në shkretëtirë për t'u tunduar nga i Keqi dhe për të dalë fitimtar ndaj tij.

Pra, ashtu siç thotë edhe Gjon Pagëzuesi, Ai që ka fuqinë të pagëzojë me Shpirtin Shenjt dhe me zjarr, rijeton në vetvete ngjarjet pashkore të popullit të lashtë të Izraelit, në pritje për të bërë Pashkën e fundit, atë të kalimit nga vdekja në jetë me ngjarjet e të Premtes së Madhe dhe të Ngjalljes. Ai, solidar me ne, bën të mundur që të jemi solidar me Të dhe të marrim pjesë në hirin që na ka dhuruar, duke anuluar dokumentin e shkruar për dënimin tonë.

Duke zbritur në lumin Jordan jo vetëm që i shenjtëron ujërat që do të bëhen për ne shenja sakramentale e pjesëmarrjes sonë në Pashkën e tij, por na paraqitet edhe si Profet që sjell mesazhin e shpëtimit: Shpirti e shuguron duke zbritur mbi të në formën e një pëllumbi; si Meshtar, sepse është i vetmi flijim i pranuar prej Atit; si Mbret-Mesi-Shpëtimtar i vërtetuar nga zëri i Atit: "*Ti je biri im!*" (Ps 2,7).

Janë ato karakteristika që, nëpërmjet pjesëmarrjes, i morëm edhe ne ditën e pagëzimit, të



cilat duhet t'i kemi fort për zemër, sepse na bëjnë të ngjashëm me Krishtin. Sidomos në këtë kohë në të cilën po jetojmë Sinodin, është shumë e përshtatshme që të rivlerësohet kjo pjesëmarrje pagëzimi në Misterin e Krishtit, duke zhvilluar gjithnjë e më shumë në Kishën tonë ato karizma dhe mbarështime të dobishme për jetën kishtarë.

Këto janë karakteristika që, në mënyrë sakramentale, janë përtërirë në shugurimin meshtarak dhe ipeshkvnor, në mënyrë që mbarështuesi i shuguruar të veprojë "*in persona Christi*", domethënë ta bëjë Krishtin vërtet të pranishëm. Dhe kjo, në mënyrë të veçantë, është e vërtetë për Ipeshkvin që vepron në personin e Krishtit kur jep mësim, kur drejton dhe kur shenjtëron popullin e Hyjit që i është besuar kujdesit të tij baritor.

Ditën e Dëftimit të Hyjit pata gëzimin që ta përkujtoj 25-vjetorin tim të shugurimit ipeshkvnor duke kremtuar në Vatikan së bashku me Papa Françeskun, aty ku u shugurova, me 6 janar 1997, nga Shën Gjon Pali II, i cili ia besoi mbarështimin tim Shpirtit Shenjt, pikërisht në atë vit të vështirë për historinë e Shqipërisë. Sot gëzimi im përtërihet prej mundësisë që ta bëj përsëri këtu, i rrethuar nga vëllezërit e mi në ipeshkvni, nga meshtarët, nga anëtarët e instituteve rregulltare dhe nga të gjithë ju, të dashur vëllezër dhe motra, që merrni pjesë në këtë Eukaristi falënderimi.

Falënderoj Zotin për praninë tuaj dhe për këto 25 vite mbarështimi ipeshkvnor jetuar në



dimensionin misionar. Dua të kujtoj këtë aspekt misionar që e ka karakterizuar gjithmonë shërbimin tim. Nuk është thjesht një fjalë, por diçka reale, sepse e kam jetuar në një kontekst në të cilin ishte e nevojshme që Krishti të rikthehej në këtë tokë që i ishte hequr me dhunë. I jam mirënjohës Zotit që më ka zgjedhur për këtë detyrë dhe më ka lejuar që të shoh përparimet në fe që janë bërë gjatë këtyre viteve, si dhe realizimin e atyre strukturave kishtare të nevojshme për jetën e Kishës dhe për shugurimin meshtarak e ipeshkvnor të shumë bijve të kësaj toke.

Në këto 25 vjet jam kujdesur jo vetëm për këtë Kishë të veçantë, por edhe për Kishën universale dhe atë evropiane, duke kryer detyrat që Ati i Shenjtë m'i ka besuar herë pas here dhe që unë i kam pranuar me një shpirt dëgjese. Edhe për këto përvoja pasuruese falënderoj Zotin.

Me siguri ka ende shumë për të ecur: udhëtimi do të përfundojë vetëm në fund të kohëve! Ne jemi vetëm shërbëtorë, vegla në dorë të hirit të Hyjit për të mirën e bijve të tij; me të gjitha kufizimet tona, e megjithatë të mbushur me Shpirtin Shenjt për ta përfaqësuar Krishtin e gjallë të bashkëkohësit tanë. Prandaj, në mënyrë të pashmangshme, do të ketë pasur edhe mangësi nga ana ime për të cilat i kërkoj falje Hyjit dhe të gjithëve ju; por jam i sigurt se Ai dhe ju do të tregoheni dashamirës me mua në lidhje me këtë gjë.

Shfrytëzoj këtë rast në të cilin përkujtojmë Pagëzimin tonë dhe shugurimin tim ipeshkvnor për t'i falënderuar të gjithë ata që bashkëpunuan me mua në mbarëshkrim: meshtarët, rregulltarët e rregulltares, dhe besimtarët e Dioqezave në të cilat kalova, edhe pse vetëm për pak kohë (Rrëshen, Lezhë, Sapë). Përfitoj gjithashtu nga ky rast për të nxitur fuqishëm një fe të gjallë në Krishtin Shpëtimtar.

Krishti qoftë zemra e jetës sonë personale: t'ia mundësojmë zemrës sonë që të rrahë në sinkron me zemrën e Krishtit!

Krishti qoftë qendra e jetës së bashkësive tona të krishtera: gjithçka filloftë prej Tij dhe gjithçka në të gjeftë plotësi!

Krishti qoftë modeli i dashurisë për familjet e krishtera: çdo marrëdhënie u bazoftë në dhurimin total të vetes, ashtu siç bëri Jezusi!

Krishti qoftë miku i besuar i fëmijëve dhe i të rinjve: u rritshin së bashku me Jezusin në moshë, urti dhe hir përpara Hyjit dhe përpara njerëzve!

Krishti qoftë mbështetja e të rriturve dhe e të moshuarve: me Ungjillin e Tij në dorë, ditshin ta drejtojnë mirë jetën e tyre, duke u bërë protagonistë me ndjenjë përgjegjësie ndaj shoqërisë dhe brezave të rinj, duke vënë në jetë atë pakt edukativ për të cilin na nxit Papa Françesku!

Krishti qoftë ngushëllimi i të sëmurëve dhe i të vuajturve: ditshin ta ofrojnë dhimbjen e tyre duke e bashkuar atë me Mundimet e Krishtit për të mirën e Kishës dhe të botës.

Zoti Jezus, i dashur në këtë mënyrë dhe i vënë në qendër të gjithçkaje, qoftë garancia e një jete të mirë e të shenjtë për të gjithë të pagëzuarit, burim thirrjesh të reja në meshtari, jetë të kushtuar dhe në mision; dhe kështu Kisha katolike në Shqipërinë tonë u bëftë gjithnjë e më shumë "*kripa e tokës dhe drita e botës*".

Të dashur, i sigurt që do të vazhdoni të luteni për mua, ia besoj pjesën tjetër të misionit tim ipeshkvnor dhe të gjithë ju dashamirësisë së Trinisë së Shenjtë, nëpërmjet ndërmjetësisë së fuqishme të Nënës së Këshillit të Mirë, të Shën Nënës Tereze të Kalkutes dhe të Martirëve tanë të lumë.

Qoftë levduar Jezu Krishti!





Dom Dritan Ndoci

KRESHMET, KOHË RRITEJE NË FE E JO PROVIM QË DUHET KALUE!

Kreshmët në Kishë kanë lindur në fillimet e krishterimit gjatë përpjekjes së disa ipeshkvijve e teologëve të cilët, atyre që do të pagëzoheshin natën e Pashkëve (shumica atë natë pagëzoheshin aso kohe), donin t'u mundësonin një ecje sa më të shëndetshme në fe!

Jemi duke filluar kohën e kreshmëve dhe natyrshëm shumëkujt i vjen të thotë: “*Këtu lidhet moti.*”, duke menduar me këto fjalë ndonjë ndërhyrje të mbinatyrshme të Zotit mbi ligjet e universit. E, lista e gjërave që mendohet se nuk mund të bëhen në këtë kohë, zakonisht përbëhet nga: “*Nuk lejohen fejesat, martesat, hedhja e themeleve për shtëpi të re e as të hyhet në shtëpi të re, duhen mbajtur të premtet e të mos hahet mish.*” Në të gjitha këta, në ligjet e Kishës, vetëm kjo e fundit ka vend, të tjerat jo. Të tjerat janë keqkuptimi i atij ligjit të Kishës që thotë: “*Mos të bëhet dasmë (që nënkupton gosti e jo kunorë martese) në mot të lidhur!*” Si t'u shpjegohet shumë të besimtarëve se Kisha këshillon të ndalohet *gosti* gjatë kreshmëve e jo *sakramentet*?

Ndoshta gaboj, por kjo lë të kuptohet se, edhe pse në popullin tonë ka dymijë vjet krishterim, ende vazhdon të trashëgohen nga brezi në brez disa aspekte të krishterimit që duket sikur ngjajnë më fort me besimet pagane që ekzistonin dikur në trojet tona. E, ato besime, si të gjitha besimet e tjera pagane në botë, kapeshin fort pas zbatimit të disa rregulloreve, me qëllim që t'u pëlqenin hyjnive e të mos shkaktonin zemërimin e tyre. Ka mundësi që edhe këtu Jezusi do të na bënte atë qortimin që i bëri Shën Filipit Apostull gjatë Darkës së fundit: “*O Filip, kaq shumë kohë jam me ju e nuk më njohe ende?*” (Gjn 14, 9)

Kreshmët në Kishë kanë lindur në fillimet e krishterimit gjatë përpjekjes së disa ipeshkvijve e teologëve të cilët, atyre që do të pagëzoheshin natën e Pashkëve (shumica atë natë pagëzoheshin aso kohe), donin t'u mundësonin një ecje sa më të shëndetshme në fe. Më vonë pastaj u mendua që kjo ecje të shtrihej për mbarë Kishën. Jo më kot të gjithë ne atë natë ripërtërijmë edhe premtimet pagëzimore. Pra Kreshmët kanë për qëllim që të na ndihmojnë të bashkohemi me dashurinë e pafund të Trinisë Shenjte, dashuri e cila na është dëftuar më së miri pikërisht në Pashkët e Krishtit. Për ta thënë edhe më thjeshtë: Kreshmët janë kohë rritjeje në fe e jo “provim” që duhet kapërcyer për të fituar vëmendjen e Hyjit.

Ajo rregulla e Kishës që ndalon mishin të premtëve dhe gostitë gjatë kësaj kohë të veçantë, nuk ka ndonjë veti ndryshimi mbi ligjet e natyrës, por dëshiron të ketë veti ndryshimi mbi ligjet e zakonit e jetës sonë të përditshme, trupore e shpirtërore. Dëshiron të na mësojë të mos jepemi tepër pas ngrënies luksoze dhe dëfrimit, por të bashkohemi me mundimet e Krishtit, që pastaj ta shijojmë sa më mirë shpirtërisht fuqinë e

Ngjalljes së Tij. Asnjë nga ligjet e Kishës nuk ka lindur për t'ia marrë shpirtin njeriut, por për ta ndihmuar atë të bashkohet më fort me Krishtin Shëlbues.

Kështu kuptohet se si në traditën e krishterë ka pasur njerëz që mund të konsiderohen si *altetë* të agjërimit e të pendesës, por që, njëkohësisht, pikërisht ata, janë shprehur edhe për rrezikun e madh që kanë po këto praktika për të krishterët. Të tillë, për shembull, ishin disa murgjër egjiptianë që jetuan në shekujt IV-V. Këta jetonin në vende të shkreta dhe njerëzit shkonin atje për t'u këshilluar prej tyre në gjërat e fesë e, pak nga pak, filluan t'i thërrisnin *Abba-Atë*. Nga historia u njohën si *Etërit e shkretëtirës*. Abba Gjoni i Shkurtër, për shembull, mësonte: “*Nëse një mbret ka ndër mend të pushtojë një qytet armik, më së pari i pret furnizimin me ujë dhe ushqime e, kështu, armiqtë, të mposhtur nga uria, do të nënshtrohen. Ndodhë kështu edhe me pasionet e mishit: nëse njeriu i lufton ata me agjërim dhe uri, armiqtë që i bëjnë luftë shpirtit, do të dobësohen.*”

Por, kur agjërimi e pendesa bëheshin shkak krenarie e përçmimi ndaj të tjerëve, atëherë ata nuk ngurronin të mësonin të kundërtën, sepse këto mëkate largojnë fuqishëm nga Krishti. Kështu thoshte Abba Izidori: “*Nëse agjëroni, mos u krenoni; po u krenuat për këtë, më mirë hani mish! Është më mirë për njeriun të hajë mish, sesa të krenohet e të shesë mend.*” E Abba Iperki shtonte: “*Është më mirë të hahet mish e të pihet verë, sesa të hahet mishi i vëllezërve me të folurën e keqe.*”

Të mos i ndajmë Kreshmët nga Krishti dhe nga dashuria që ai na ka mësuar. Le të mendojmë se çfarë duam të bëjmë gjatë kësaj kohe të shenjtë e jo të kufizohemi vetëm tek gjërat që nuk duhet të bëjmë. Përveç mbajtjes së rregulloreve që, siç e pamë, e kanë dobinë e tyre, le ta thellojmë fenë tonë edhe me praktika të tjera shpirtërore: le të shtojmë, për shembull, ndonjë uratë më shumë në lutjet tona, të marrim pjesë në meshë e të rrëfehemi më shpesh, të gjejmë kohë të lexojmë ungjillin, të lexojmë ndonjë libër shpirtëror që na thellon në fe, të ndihmojmë sadopak ndonjë nevojtar, të vizitojmë dikë që ndoshta pret të na shohë më shpesh, të përpiqemi ta sulmojmë ndonjë ves të keq në të folurën tonë e, secili, mund të “shpikë” edhe të tjera të ngjashme.

Le të mendojmë, pra, se si të rritemi në dashuri për Zotin e për njëri-tjetrin e, kështu, do të arrijmë në natën e Pashkëve të ngjallur edhe ne bashkë me Krishtin.



Dom Nosh GJOLAJ
Podgoricë

KULTIVIMI I DURIMIT DHE I NJOHJES

(Pjesa e katërt)

Bashkësia e martesës kërkon takimet e shpeshta dhe dialogun (bisedën)!

Ankohet çifti martesor: “Ja, dhjetë vite jemi të martuar dhe jetojmë së bashku me bashkëshortin në bashkësinë e martesës, fare nuk e kuptoj, jemi tjetërsua dukshëm, përderisa me juve e ndjej veten mirë dhe afër!” Tjetri thotë: “Nuk e dija, se çka ndodhi mes neve, si drejtor i firmës, i kam raportet e mira me punëtor; por fatkeqësisht nuk i kam fare me bashkëshorten time, mos themi raportet tona kanë ra në nivelin e hipokrizisë dhe dyfytërsisë!”

Martesa nuk është jetë individuale, por është jeta e përbashkët, e raporteve e cila zhvillohet gjithëherë nëpër mes dialogut (bisedës). Raporti mes çiftit martesor mund të luhatën nga ekstremi deri në tjetrin ekstrem (prej një skaji në tjetrin skaj). Biseda po ashtu mund me qenë e sinqertë dhe e çelur e cila është pors i shiu i verës në tokën e thatë, por mund me qenë fatkeqësisht pors i nafta në zjarrin e hapur. Në ato bashkësi martesore, ku mbretëron pak a shumë dashuria dhe mirëkuptimi, aty zhvillohen raportet normale si edhe biseda zhvillohet në mënyrë spontane dhe të natyrshme, nuk lejojnë që të krijohet ndonjë pengës mes vetes apo mure prej çimentos. Me sy çelur e ruajnë kopshtin e martesës. Siç thotë fjala e vjetër: “kujdesi me kohë është më mirë, se sa shërimi!” Atëherë kuptohet vetvetiu në familjet e

tilla mbretëron gjithëherë atmosfera festive, edhe pse barra e kryqi mund me qenë e rënd.

Sjellja spontane dhe e natyrshme në raportet e përditshme mes partnerëve është kusht për një jetë sadopak normale dhe njerëzore. Në bashkësinë e ngritur dhe të fisnikëruar nuk përdoren fjalët fyese, të cilat kanë dalë moti nga përdorimi, po ashtu nuk ka frik njëri nga tjetri. Çdo njëri e përjeton tjetrin, ashtu siç është dhe së bashku e gjejnë atë telin e harmonisë. Aty nuk ka vend frika dhe as tallja as hipokrizia, nga fjalët që i shprehim nga ai tjetri, po ashtu aty nuk ka vend as mbiçmimi as nënçmimi i tjetrit. Të gjithë janë të bindur, se fjala e gjen mundësin optimale e shpjegimit për të mirë, siç thotë fjala e vjetër “ata janë një mendje e një zemër!”

Përderisa në familjet e dështuara, mbretërojnë pikëpamjet e sëmura apo hipokrizi. Moskujdesi me kohë për pastrimin e kopshtit martesor, mungesa e dialogut, ose e raporteve, se gjoja nuk kemi kohë. Të punësuar dhe të lodhur nga puna e përditshme dhe i shmangemi kontaktit dhe bisedës. Vetvetiu kuptohet se në bashkësinë e tillë lajmërohen dashje apo pa dashje edhe sëmundjet e llojllojshme që fillojnë nga vetmia, mërzia, dhe lehtë mund të tejkalojnë në sëmundje psikike dhe hysterike deri te çrregullimet e personalitetit. Partnerët, që vuajnë nga histeria, ata nuk mund të gjejë mënyrat për bisedë (dialog), kontakte me tjetrin për zbritjen e tensionit në





familje. Po qe se janë edhe plotë vete, që zakonisht i shoqërojnë edhe ndjenjat dhe dëshirat e porealizueshme, ata jo vetëm se nuk dinë dhe nuk mund në tjetrën të jetësohet, por u mungon edhe spontaniteti i natyrshëm dhe bujaria e fisnikëruar. Njeriu i tillë, gjithherë është i ngarkuar, i pakënaqur, murmuritë, zakonisht i shoqëron ndonjë qeshje ironike. Flasin vetëm për vete dhe pakënaqësinë që i ka përjetuar. Flasin shumë për vështirësitë e jetës ose për padrejtën që i bëhet, po ashtu ata gjithherë vuajnë. Vetvetes i çuditet, se si ai tjetri përskaaj tij, nuk e sheh barrën dhe vuajtët e tija, dhe së paku nuk kujdesohet për me ndonjë fjalë ngushëlluese! Atëherë si mund t'ia kuptoj kryqin dhe vështirësitë e tija, edhe pse jetojnë së bashku nën një kulm, në bashkësinë e martesës! Nga vetë fytyra i tij reflekton vuajtja dhe mjerimi, i cili gjendet në varfërinë shpirtërore. Komunikimi me tjetrin është dukshëm i penguar. Pothuaj në çdo pyetje ata përgjigjen: “Kjo nuk është puna e juaj!” Në qoftë se dëshironi edhe më tutje ta zhvillon dialogun me të, por ai gjithherë u shmanget pyetjeve.

Ja një shembull imagjinuar lidhur me jehonën e zërit, të urrej ose të dua:

Ishte një herë një djalë i quajtur Toni, me shtat i vogël por shumë zemërak. Edhe pse ishte zemërbardhë shpeshherë shpërthente duke u zemëruar në jetën e përditshme. Ai ecte nëpër dhomën e tij duke bërëtitur si i tërbuar, kur nuk i shkonin punët ashtu siç ai dëshironte.

Një ditë prej ditëve nëna shkoi në qytet për të tregtuar, kurse Toni ishte vetëm në shtëpi, i cili shkoi në kuzhinë dhe e gjeti një kuti me biskota ku nëna me kujdes i ruante. Ai i merr dhe me oreks të mirë i hëngri. Pasi nëna kthehet nga qyteti, dhe e zbulon se kutia e biskotave ishte e zbraztë dhe e pyet Toni: “A i ke ngrënë ti biskotat nga kutia?” Toni menjëherë përgjigjet: “Jo nënë, as një biskotë nuk kam hëngër! Sigurisht se jo, të betohem se nuk i ka prekur!” përgjigjet Toni. Nëna e hidhëruar i bërtet Tonit: “Ti rrenacak! A të kamë mësuar që gjithherë të folës të vërtetën dhe të jesh i sinqertë !” Dhe ja përvjel një flakaresh.

Toni hidhërohet , i mbushur plot inat shpërthen duke i thënë nënës: “Të urrej! Të urrej! Dhe do të dal prej shtëpie dhe nuk do të kthehem më!”

Toni i hidhëruar e braktis shtëpinë dhe fshatin dhe shkoi thellë në pyll. I mërziur dhe i tërbuar nga inati, rishitas filloi të bërtasin me gjithë fuqinë që kishte: “Të urrej! Të urrej!” Dëgjon mbrapa jehonën e zërit të vetë: “Të urrej! Të urrej!, Të urrej”. Nga frika Toni thotë: “Ti më urrej mua! Ti më urrej mua? Kush je ti?”

Aq e kap frika dhe Toni u kthye në shtëpi, dhe e përkëdhel nënën: “Mami, mani, kam frikë! Dikush më urren! E kam dëgjuar , se dikush ka bërëtitur dhe më thotë se më urren!”

I dashur Toni imë!” I përgjigjet mani: “Ku e ke dëgjuar? Dhe ma trego vendin.” Toni i thotë:” në pyll larg nga shtëpia. Eja dhe do ta tregoj vendin.”

E merr nënën përdoret dhe shkojnë në pyll. Pas një kohës arrin te shkëmbi dhe Toni tregon vendin. “Këtu! Shih këtë shkëmbe? Këtu jam ulur dhe një njeri i keq ka bërëtitur: ”Të urrej! Të urrej!”

Në rregull i përgjigjet nëna: “Qetësoju dhe bë ata çka do të them unë.” Po i përgjigjet Toni i frikësuar.. Dje nëna i thotë: “Merr frymë thellë , dhe mbushi mushkëritë me ajër Pastaj me sa fuqi të kesh, bërtit: Të dua! Të dua! Të dua!” Dhe Toni bënë ashtu siç i thotë nëna. Dhe menjëherë dëgjon jehonën mbrapa: “Të dua! Të dua! Të dua!” Toni buzëqeshë dhe nga gëzimi edhe njëherë sprovon me sa kishte fuqi: “Të dua! Të dua! Të dua!”

Nëna e pyeti Tonin se çka dëgjon tani, kush ishte armiku apo kush ishte miku yt?”

Çdo njëri prej neve ka nevojë për tu shikuar në pasqyrë, sepse nuk e shohim veten as fytyrën tonë, ashtu kemi nevojë për njerëzit e tjerë, siç e shohim veten në pasqyrë e shohim qëndrimet tona ndaj të tjerëve. Ai tjetri është pasqyra e shpirtit. Në raportin ndër njerëzor është e rëndësishme sjelljet tona ndaj tjetrit, që reflektojnë si jehona e zërit apo si pasqyra. Ato gjëra si i themi dikujt ata jemi ne. Atëherë pse mos ta shfrytëzojmë buzëqeshjen, fjalët e buta dhe të ëmbla dhe të mira, mirësjelljen me tjerët dhe kështu i përmirësojmë raportet dhe nuk na kushton shumë. Ta marrim shembullin e Nënë Terezës...

Histeriku zakonisht kurrë nuk gjen kontakt me tjetrin, ai vetëm kontaktin e nxitë. Vetëm psikologu i mirë, mund ta kuptoi. Psikolog i tillë duhet me qenë edhe bashkë partneri, i cili duhet ta gjej kontaktin me të, i cili vuan nga histeria apo ndonjë sëmundje tjetër psikike ose prapë nga ndonjë tjetër çrregullimit psikik. Ky është edhe kushti i parë, për ta krijuar raportin me atë tjetrin, me të cilin e ndajnë fatin e jetës martesore. Po qe se nuk arrij çifti për t'i krijuar urat me bashkë partnerin, atëherë shumë shpejt fillon bashkësia të zbehet dhe e humb domethënien e vlerës së vet. Bashkësia nuk është i përbërë prej dy boteve të mbyllura, po qe se nuk i shkëmbejnë mes vete mendimet, përvojat siç janë: fjalët e ëmbla dha dashurinë, një buzëqeshje, duke ikur fyerje e lëndimeve, dhe mos flasim për shkëmbimin e dhuratave e dashurisë, që nuk i lejojmë të çoroditen deri në nivelin e kafshës, që nuk është asgjë tjetër, përveç shfryrja e epshit seksual, dhe seksi mbetet vetëm objekt i epshin. Martesa e tillë kuptohet vetvetiu është e pa mundur dhe sterile (shtrembët).



Moter MARJETA GJOKA

Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta

JETA E KUSHTUAR NË KISHË DHE PËR KISHËN **Në ecje me popullin e Hyjit**

«Dilni në mbarë botën dhe predikoni Ungjillin të gjithë njerëzve» (Mk 16, 15).



Kurrë më shumë se sot dëgjohet nevojshmëria për një ftesë ndaj jetës së kushtuar që të rinisë edhe njëherë predikimin e Ungjillit të vëllazërisë mbi një bazë të re, sepse e nesërmja do të jetë për jetën e kushtuar një mundësi ku të supozojë mënyra të hapura veprimi, gjithmonë duke pasur një urti ungjillore.

Siç e dimë, gjatë vitit mbi jetën e kushtuar Ati i Shenjtë në katekezat e tijë na ka rikujtuar tre objektiva thelbësore, *Ungjillin, profecinë dhe shpresën*. Mund të themi që këto objektiva nuk kanë të bëjnë vetëm me të kushtuarit, por me jetën e çdo të pagëzuarit, sepse e bëjnë të dukshme marrëdhënien shumë të ngushtë midis jetës së kushtuar dhe Kishës.

Të shikojmë të kaluarën me mirënjohje, të njohim dhe të rizbulojmë shkëndijat frymëzuese të idealeve, projekteve, vlerave që i dhanë jetë formave të jetës së kushtuar do të thotë, siç thoshte kompozitori Gustav Mahler, të kemi kujdes «ruajtjen e zjarrit, dhe jo adhurimin e hirit».

Në rrënjë të çdo gjëje është vetëm Ungjilli, për themelueset dhe themeluesit rregull absolut ishte Ungjilli, çdo rregull tjetër kishte për qëllim të ishte vetëm një shprehje e ungjillit dhe një instrument për ta jetuar atë në plotësi. Ideali i tyre ishte Krishti dhe do t'i përmbaheshin plotësisht, deri në atë pikë sa të mund të thoshin me Shen Palin: «Vërtet, për mua Krishti është

jetë[...]» (Fil 1, 21). Në këtë kuptim, kthimi në rrënjët e karizmës do të thotë nga njëra anë gjetja e drejtimit të jetës në Ungjill, nga ana tjetër për ta konkretizuar në jetën e përditshme nëpërmjet veprave, në praninë e njerëzve të kohës sonë, për të qenë një shenjë e besueshme e pranisë së Shpirtit Shenjt duke shtuar në zemrat e njerëzve dëshirën që të gjithë të jenë një. Personat e kushtuar duhet të jenë Ungjill i mishëruar, ata janë kujtesa e gjallë dhe efektive e asaj që Hyji ka bërë dhe bën për ne. Siç shkruante Jean Marie Tillard, në rrënjën e çdo jete autentike rregulltare ne gjejmë si motivimin e parë dhe të gjithanshëm, një rregulltarë nuk është për vetveten, por është për shkak të Krishtit. Nuk bëhemi rregulltarë për diçka, por për shkak të dikujt, të Jezu Krishtit dhe për magjepsjen që Ai ushtron. Ashtu si Simoni i moshuar e priti ardhjen e Hyjit gjatë gjithë jetës së tij dhe e lavdëroi praninë e Tij në fëmijën Jezus të paraqitur në tempull, kështu të kushtuarit janë burra dhe gra të kujtimit dhe të prirjes së Hyjit.

Të përqafojmë të ardhmen me shpresë, vetëm kështu të rrënjësuar në Ungjillë, shpresa hyn në botë, vetëm në këtë mënyrë pa i mohuar vështirësitë, i përqafojnë ato dhe i tejkalon. Shpresa pret diçka pozitive për të ardhmen, por që në të njëjtën kohë duhet të mbështetë të tashmen tonë; është mbështetja e



lirë dhe e pakushtëzuar në një premtim, të rrënjosur në Krishtin. Sepse shpresa për të cilën po flasim nuk bazohet në numra apo vepra, por tek Ai tek i cili ne kemi besuar (krh. 2 Tim 1,12), dhe për të cilën asgjë nuk është e pamundur, (krh. Lk 1, 37). Kjo është shpresa që nuk zhgënjën dhe që do të lejojë jetën e kushtuar të vazhdojë të shkruaj një histori të madhe në të ardhmen, tek e cila duhet të mbajmë vështrimin, të vetëdijshëm se Fryma e Shpirtit Shenjtë na shtyn drejt Krishtit që të bëjë me ne gjëra të mëdha, (krh. Papa Françesku, letër drejtuar të kushtuarve n.13). Ashtu si Simoni dhe Ana, që jetuan me shpresën e ardhjes së Shpëtimtarit, gati për të festuar në orën e takimit, kështu personat e kushtuar janë njerëz shprese, të thirrur për të parafytyruar të ardhmen e Hyjit në të tashmen e të gjithë njerëzve me fjalën dhe jetën e tyre.

Të jetojmë të tashmen me ndjeshmëri, sepse ajo çfarë e karakterizon jetën e kushtuar është profecia. Ashtu si profeteshja Ana, e cila i komunikoi me gëzim të gjithëve mrekullitë që Hyji ka bërë dhe do të bëjë, po ashtu edhe personat e kushtuar janë të thirrur për të qenë profetë. Profeti është ai që mishëron Fjalën e Hyjit, sepse i jep Asaj një trup dhe një histori konkrete. Ai shpall një fjalë hyjnore që krijon historinë, e interpreton dhe bëhet bartës i saj. Është Hyji Ai që e vendos fjalën e tij në buzët e Profetit dhe ia dërgon atë si mesazh popullit të Tij. I shuguruar dhe i mbështetur nga Shpirti Shenjt, profeti është i thirrur, «t'u sjell të përvujtërve lajme të gëzueshme, t'i shërojë ata që kanë zemrën e plasur, tu shpall skllëvërve lirinë, të burgosurve çlirim», (Is 61, 1). Fjala që Shpirti Shenjt vendos në zemrën dhe gojën e profetit është vetëm një fakt verbal, por është një ngjarje që ndodh. Kjo do të thotë se siç funksionon Fjala tek ne, veprimi ynë, puna jonë është fryt i asaj Fjale; është veprimi ynë ai që duhet të zbulojë fjalën që na është shpallur; fjala është efektive nëse funksionon, vepra është efektive nëse është fryt i fjalës. Profeti çdo ditë që zgjohet qëndron në dëgjim, dhe shkon në shkollën e Hyjit, që të mund të ushqehet dhe të jetë në gjendje t'i përgjigjet të lodhurve. Kërkoni fjalën e Hyjit për të qenë një njeri shprese, pa këtë takim të përditshëm askush nuk mund t'i japë përgjigje askujt, as lodhjes së vet dhe as lodhjes së të tjerëve. Të kushtuarit janë të thirrur që të jenë profet që bashkëpunojnë për riparimin e Kishës dhe të shoqërisë, që e shndërrojnë fuqinë në shërbim, zotërimin në kujdestari, duke e shoqëruar popullin e Hyjit në dritën e Ungjillit, si një rojtar që qëndron zgjuar natën dhe e din kur vjen agimi. Benedikti XVI thoshte që rregulltarët e sodisin dritën e Hyjit, e cila vjen për të ndriçuar botën, dhe shikimi i tyre profetik hapet drejt së ardhmes, si shpallje e Mesisë.

Paradigmë e re, jeta e kushtuar pjesë e popullit të Hyjit

Termi «paradigmë» do të thotë *model referimi*, e «re» i referohet asaj që nuk kujton identitete të

paracaktuara në stinët e largëta kulturore. Kjo është ajo që i duhet një Kishe dhe jo më pak jetës së kushtuar. Papa Gjoni XXIII ka thënë se ka ardhur ora kur kisha duhet të thotë atë që Krishti mendoi dhe dëshironte për të (Fjalim, 14 shtator 1964). Në këtë thënie nuk është vetëm pohimi se Hyji shfaqet në një zbulesë historike që është në kohë, por duhet të themi se Kisha ndër vite nuk ka thënë gjithmonë atë që Krishti mendon për të, duke preferuar t'u përgjigjet pyetjeve të së tashmes vetëm me atë që njeh, pa e kuptuar se koha e pabanuar nga historia duke u bërë ciklike e bën të ardhmen të zhduket, dhe mbetet e mbyllur në një të tashme të ngushtë. Dhe kjo është arsyeja pse jeta e kushtuar tani duhet të kërkojë një figurë historike më domethënëse për njeriun e sotëm, që e vendos atë në horizonte të reja kuptimore, (krh. José Rodriguez Carballo, takimi i jetës së kushtuar, *Aquileia* 02.06. 2015). Tashmë gati njëzet vjet më parë, udhëzimi për të rifilluar nga Krishti, i kongregatës së jetës së kushtuar shkruante se: personat e kushtuar janë të detyruar t'i bëjnë vetes shumë pyetje në lidhje me kuptimin e identitetit të tyre dhe të ardhmen e tyre, (krh. Të rifillojmë nga Krishti, udhëzime, të kongregatës së jetës së kushtuar, 2002 n.12). Arsyeja qëndron në faktin se nuk jemi më në kohën kur njeriu ndërtoi të ardhmen e tij me asimilimin e asaj që mori nga paraardhësit e tij, duke e bërë gjithçka të pandryshueshme, dhe duke menduar për një lexim jokritik të të dhënave biblike - bazuar në zbulesë. Prandaj është e nevojshme të përparojmë të lirë nga parakuptimet dhe parapërcaktimet që vijnë nga kohrat që nuk ekzistojnë më, në mënyrë që të vendosim të jetojmë sot përvojën primitive të krishterë të lirisë ungjillore, me atë përkushtim, por edhe me atë butësi origjinale, të vështruar në fjalët e Mësuesit: *e shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunën* (krh. Mk 2, 27), se përndryshe rregulltarët dhe regulltarët do ta gjejnë veten të njohur si ata që jetojnë, sepse tashmë kanë marrë disa zakone të mendimit dhe jetës, dhe jo si transparencë e ndihmës së krishterë e pasur me një njerëzim të ri.

Gjatë koncilin, Ipeshkëvi P. M. Richaud vlersoj të arsyeshme të hiqej emri «regulltarë» në favor të «jetës rregulltare», por jo i kënaqur ai propozoi që skica të thoshte thjesht traktat mbi të krishterët, veçanërisht kushtuar Hyjit dhe shpitrave (krh.G. Alberigo, *Historia e Koncilin të Vatikanit II*, Molino, Bologna 2013). Jo pohim i panevojshëm duke pasur parasysh faktin se diversiteti i jetës në kushtim nuk është për shkak të një elementi teologjik që e dallon atë nga të tjerët, por për faktorë të ndryshëm, sa të ndryshme janë kohët brenda të cilave ajo është zhvilluar. Që nga koncili e tutje dhe në ndarjen e jetës së të gjithë personave të kushtuar ftohen të zbulojnë fytyrën e Hyjit, duke investuar jetën e tyre për t'u kthyer njerëzve të rrugës Ungjillin që u përket. Prandaj është koha për të aktivizuar bashkëpunimet, për të



bashkëpunuar duke u integruar me njerëzit që në një territor të caktuar kanë një ndikim të mundshëm në mobilizimin e ndryshimit të pritur. Jeta rregulltare nuk mund të shihet si një kategori e të krishterëve të veçuar, përkundrazi rregulltarët duhet t'i referohen jetës së krishterë në përgjithësi, pasi ata janë pjesë e popullit të Hyjit dhe me jetën e tyre duhet ti japin kuptim reciprocitetit. Ky bashkim nuk do të thotë thjesht bashkim, por ndërjegjësim për identitetin e tyre, për t'u hapur ndaj të tjerëve. Kjo gjë ka të bëjë edhe me të jetuarit së bashku në mënyrë që ne të mos jetojmë më krah për krah në një paqartësi reciproke ndaj njëri-tjetrit, por të realizohet një relacion shkëmbimi mes tyre, pasi besimi i krishterë ka elementin e tij kryesor pikërisht në relacionet e vërteta dhe të mira, të shëndetshme dhe interesante. Nga kjo rrjedh fakti se një formë e jetës që rrotullohet rreth vetes nuk është më e kuptueshme dhe as e këndshme. Vështirësitë e jetës së kushtuar janë në kulturën e saj të ankoruara në mentalitetin e kohës në të cilën mendohej se për të identifikuar veten, duhej të theksoheshin ndarjet sesa plotësimi i diversiteteve. Përpjekja për të takuar njerëz aty ku janë shumica e tyre, ku shprehen lirshëm, ku hasen problemet reale me rrezikun e të jetuarit mes tyre të ndarë nga një atmosferë e rremë (krh. Y. Congar, *Për një Kishë shërbëtore dhe të varfër*, Qicajon, Magnano (BI) 2014). Nëse tani jeta rregulltare është e varfëruar, ajo duhet të gjejë shkakun në mos fekondimin nga kontaminimi i ndryshëm i marrëdhënieve dhe kontakteve intensive njerëzore me të tjerët. Sot, ndryshe nga e kaluara, marrësit e propozimeve të veçanta ungjillore janë të gjithë të krishterët dhe nëse ndjekja e personave të kushtuar është në shërbim të ndjekjes së të gjithë të pagëzuarve, atëherë mesazhi ungjillor i jetës rregulltare nuk është që e dallon atë në përfaqësimin e intensitetit të një vlere të caktuar. Jeta e kushtuar e kënaqur me shkallën e saj të fortë të mjaftueshmërisë, ajo bëri zgjedhjen e marrëdhënieve funksionale në vend të atyre reale, duke i bërë ata të humbnin në kulturën e popullit, domethënë në idetë dhe mënyrat e të jetuarit të parfumuar nga jeta. Prandaj nevoja për të bashkëvepruar me terrenin në të cilën është vendosur fara përmes përvojave intensive të marrëdhënieve, të cilat i bëjnë që rregulltarët dhe rregulltares të kalojnë nga puna «për» në punë «me». Të jesh «me» shprehet mirë në fjalët e Papës: «ungjillëzuesit të kenë erën e



deleve» (Papa Françesku, *Evangelii Gaudium*, Ancora, Milano 2013, n. 24). Nga kjo shprehje mund të lindin modele të reja shërbimi për një njerëzim të ri.

Të kalojmë nga «vetvetja» tek të «tjerët» që të jemi model bashkimi

Pikërisht ishte ky urimi i Papa Françeskut në rastin e vitit të jetës së kushtuar, i cili me letrën apostolike drejtuar personave të kushtuar, ai hodhi një sy tipareve të frytshmërisë për jetën e bashkimit duke ftuar që të krijohen vende ku jetohet logjika e dhuratës, vëllazërisë dhe e pranimit të diversitetit, (krh. Papa Françesku, *Leter baritore të gjithë të kushtuarve me rastin e vitit të jetës së kushtuar*, n. 2). Vende që premtojnë të ndihen si udhëtarë me ata që ecin dhe kërkuese me ata që kërkojnë marrëdhënie njerëzore, që të jenë fryti dhe shenja e përparësisë së dëgjimit të Fjalës mbi çdo gjë tjetër. Këto përvoja janë thënë në *Evangelii Nuntiandi*: Përhapja dhe rritja e këtyre shoqatave dhe lëvizjeve të reja mund të interpretohen si një veprim i Shpirtit që hap shtigje të reja në harmoni me pritshmëritë e tyre, dhe me një kërkim shpirtëror dhe të thellë të ndjenjave më konkrete të përkatësisë, që i bën ata të jenë një pasuri për Kishën duke u frymzuar gjithmonë nga Shpirti Shenjt që i nxit vazhdimisht për të ungjillizuar të gjitha mjediset dhe sektorët, (krh. *Evangelii Nuntiandi* n. 29). Shprehja e së vërtetës mund të jetë e shumëanshme dhe ripërtëritja e formave të shprehjes është e nevojshme për të transmetuar mesazhin ungjillor në kuptimin e tij të pandryshueshëm tek njeriu i sotëm, (krh. Papa Françesku, *Evangelii Gaudium*, Ancora, Milano 2013, n.41). Kjo shumëllojshmëri modelesh është një element që tregohet si pasurues, thuhet edhe në dokumentin e kongregatës për të kushtuarit, se njohja



pozitive e diversifikimit të modeleve dhe stileve të jetesës vëllazërore përbën sot një nga rezultatet më domethënëse të frymës novatore të Koncilit, (krh. Kongregata për institutet e jetës së kushtuar dhe shoqatat e jetës apostolike, *Gëzohuni*, Vatican 2014). Këtu ekziston pranimi i nënkuptuar se në to ka traktate të plotësisë që duhet të vlerësohen edhe nga jeta rregulltare, sepse ato bazohen në kategori bashkëkohore në format e qasjes dhe komunikimit, të spontanitetit të menjëhershëm. E gjithë kjo buron nga vëzhgimi se edhe sot në një botë shqetësimi dhe mirëpritjeje, ka nostalgji për marrëdhëniet personale dhe komunitare, e cila shprehet veçanërisht në përhapjen e grupeve, lëvizjeve, shoqatave dhe në të cilat paradigma antropologjike supozon qëndrueshmëri dhe dukshmëri në histori. E kemi të nevojshme të kemi forma jete që nisin nga ungjilli dhe janë të afta të krijojnë hapësira të reja, ku janë të hapura ndaj mirëpritjes për të dialoguar dhe për tu relacionuar me të tjerët gjithmonë në dëgjim sipas nevojshmërisë së tyre. Na nevojitet një shpirtërim i krishterë që di të tregojë edhe disa nga virtytet më urgjente shoqërore: përgjegjësinë, lirinë, dinjitetin njerëzor, solidaritetin, të drejtat e njeriut dhe tolerancën, (krh. B. Secondin, *dëshirat shqetësuese të shpirtërimit*, Bologna 2012). Aspekte që vijnë për të thënë se dukshmëria bindëse nuk është më ajo institucionale, por jepet vetëm nga dëshmia e fuqishme dhe e përvujtë e jetës, që i flet njeriut të sotëm përmes formave të jetës vëllazërore ku nëpërmjet kësaj forme jete marrin frymë dhe ushqehen me aromën ngushëlluese dhe çliruese të Ungjillit, duke marrë përsipër karakteristikat, kulturën dhe vlerat njerëzore e fetare të territorit në të cilin ndodhen në mënyrë që të përshtaten duke kërkuar gjithmonë bashkimin si formë jetë. Për këtë duhen përgjigje të brumosura me ato të thirrjeve që përbëjnë Kishën, sepse sot më shumë se kurrë jeta e kushtuar po bëhet sterile sa herë që ajo mbyllet në vetvete dhe humbet horizontin e saj.

Paradigma e re dhe bashkësia si një zemër e vetme dhe një shpirt i vetëm (krh. Vap 4, 32)

Me fjalët e mësipërme, Papa thotë se nuk ka bashkësi pa një takim të vërtetë, sepse bashkësia bëhet bashkim dhe sakrament shpëtimi, kjo ndodh kur është komunikimi që bëhet ndarje e vërtetë. Nuk mund të flasim për një bashkësi të vërtetë kur në mardhënien me Krishtin dhe me të tjerët kanë të bëjnë vetëm në nivele organizative dhe administrative, dhe me tensione mbi asgjë, një bashkësi e vërtetë formohet me hapsira të njerëzimit të qetë, që transmetojnë dëshirën për t'u takuar dhe frekuentuar me njëri - tjetrin, është kështu që ato pasurohen. Papa Françesku insiston veçanërisht mbi domethënjen për të qenë vëllazëri, ky

term nuk duhet të kuptohet vetëm në kuptimin shpirtëror-universalist, institucional por në shprehjen e afërimitit, që mund të imagjinohet si një model i marrëdhënieve midis njerëzve me të cilët është e mundur të ketë marrëdhënie pozitive, një komunikim të sinqertë, jo pa empati, që do të thotë të kemi aftësinë për të kuptuar të tjerët në atë që mendojnë, ndjejnë dhe dëshirojnë: kështu Kisha mund të tregojë fytyrën e saj gjeneruese.

Prandaj jemi të thirrur t'i nënshtrojmë kritikës historike shumë prej presupozimeve kulturore që kemi sjellë me vete nga kohët e tjera, një prej të cilave është të identifikojmë jetën e *koinonisë*, jetën në bashkësi e mos të mbesim thjesht në një jetë vetëm të mbledhur në një çati. Prandaj rreziku, veçanërisht për ato komunitete që janë numerikisht të rëndësishme, të mbahen pas një konceptimi kolektiv, sipas të cilit sistemi i vlerave do të qëndronte së bashku dhe kjo do të mjaftonte për të njohur veten si vëllezër e motra pavarësisht nga cilësia dhe numri, të komunikimeve të drejtpërdrejta. Tani jeta e kushtuar nuk duhet të ketë frikë të distancohet nga vetvetja, nga një stil i caktuar dhe nga universi i saj konceptual në mënyrë që të jetë në gjendje të ndërtojë një jetë në bashkësi e cila kjo formë jete e drejton atë që të jetë një krijesë e re në ditët e sotme, ku mund të shprehin një pjekuri të duhur. Atëherë çështja serioze për jetën e kushtuar sot është rinisja e Ungjillit të vëllazërisë mbi një bazë të re, sepse nesër do të jetë ajo jetë e kushtuar që do të dijë të supozojë mënyra të hapura pune dhe ëndrra fleksibël, plot imagjinatë dhe urti ungjillore. Në çdo rast, ata nuk do të mbajnë më ato skema të jetës në bashkësi me koncepte kolektiviste për të cilat është sistemi i traditave që mban së bashku me dokumentet, deklaratat, teoritë por do të mbajnë konkretësinë e veprimtimit ndërpersonal të përbërë nga ndarja, solidariteti, miqësia, mirëkuptimi dhe toleranca. Është e nevojshme të ketë struktura ku të gjithë të ndihen si bijë dhe bija, që ndihmojnë në rritjen e pjekurisë për të jetuar si vëllezër e motra. Vetëm kur të arrihet në një pjekuri reciprociteti dhe vëllazërimi në bashkësi mund të arrihet për t'ju përgjigjur ftesës së Papa Françeskut, mos u palosni në vetvete, mos lejoni që të asfiksoheni nga grindjet e vogla të shtëpisë, mos mbeteni robër të problemeve tuaja. Dilni jashtë për të ndihmuar të tjerët duke zgjidhur problemet e tyre dhe duke ju shpallur lajmin e mirë, kështu do të gjeni jetën duke dhënë jetë, shpresën duke dhënë shpresë, dashurinë duke dashur.

Në detin e stuhishëm të së tashmes, jeta e kushtuar është e thirrur të jetë një paqebërëse, një dritë shprese, një shenjë e dukshme e dashurisë së mëshirshme të Hyjit për botën. Shkoni në të gjithë botën e predikoni ungjillin të gjithë njerëzve (krh. Mk 16), ishte fjala që Jezusi u drejtoi dishepujve të tij, dhe të njëjtën ftesë vazhdon të na e bëjë gjithsecilit prej nesh.



TË RUHEN DHE REPSEKTOHEN TRADITAT FETARE DHE ATDHETARE!

*Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, Konferencë Ndërkombëtare dhe Ndërfetare
“Vëllazëria në Humanizëm”*

Tiranë 10 shkurt 2022



Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë në bashkëpunim me Këshillat Ndërfetarë të Evropës ka organizuar me 10 shkurt 2022, konferencën ndërkombëtare dhe ndërfetare “Vëllazëria në Humanizëm” me pjesëmarrjen e liderëve të komuniteteve fetare, ambasadores së SHBA-së në Tiranë Yuri Kim, Nuncit Apostolik Imzot Luigi Bonazzi dhe Presidentit të Këshillave Ndërfetarë të Evropës Dr. Luigi de Salvia! Në aktivitetet morën pjesë klerikë myslimanë dhe të krishterë, përfaqësues nga bota akademike, intelektualë dhe studiues, si dhe të rinj e të reja nga të gjitha komunitetet fetare.

Në seancën e parë të moderuar nga Dr. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH-së dhe zv/president i Këshillave Ndërfetarë të Evropës, kanë përshëndetur pesë krerët e komuniteteve fetare në vendin tonë njëkohësisht dhe anëtarë të Bordit të Presidencës.

Dr. Kruja në fjalën e hapjes ka thënë ndër të tjera se, “sot edhe pse bota njeh kulmin e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, shumë vende po përballen me sfida të reja dhe të vjetra, me konflikte, intolerancë dhe gjuhë urrejtjeje, varfëri dhe korrupsion. E pikërisht në këto kohë sfidash

dhe përballjesh me to, nuk mungojnë dhe përpjekjet për dialog dhe bashkëpunim, jo vetëm nga shtete dhe organizma ndërkombëtarë zyrtarë, por sidomos nga liderë botërorë të besimeve të ndryshme fetare, siç ishte dhe nënshkrimi i dokumentit të vëllazërisë njerëzore nënshkruar midis Papa Françeskut dhe Imamit të Madh të Ez'herit Shejh Ahmed el Tajjib, si autoritetet më të larta të tyre fetare.” Më tej ai ka bërë dhe një pasqyrë të aktiviteteve të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Kryetari i KNFSH-së për vitin 2022 dhe njëkohësisht Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë Pastor Ylli Doçit, në fjalën e tij ka vlerësuar harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfetare në vendin tonë, që buron nga toleranca dhe tradita shqiptare, si dhe dokumentin e paqes nënshkruar në Abu Dhabi.

Ndërsa Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu në fjalën e tij tha: “Apeli im kryesor është për politikën, investoni në arsim. Për mediat, transmetoni frymë paqësore, mos raportoni informacione të paverifikuara, kushtojini më shumë rëndësi rolit tuaj edukues krahas atij të fitimit. Për qytetarët dhe besimtarët;



përdorini mjetet e komunikimit dhe teknologjinë për qëllime të mira, mos bini pre e kotësive, manipulimit, mos shkoni pas frymës së përçarjes, urrejtjes, linçimit e dhunës verbale nëpër rrjeteve sociale.

Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Fortlumturia e tij Anastas Janullatos ka thënë ndër të tjera se, “në Shqipëri, gjatë dekadave të fundit, në periudha krizash të brendshme, të gjitha komunitetet fetare u përpoqën që të bashkonin zërin dhe përpjekjet e tyre për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Sot duam të theksojmë se, në përgjithësi, temat konkrete për të pasur një dialog krijues midis komuniteteve fetare të ndryshme janë: mbrojtja e mjedisit, lehtësimi i varfërisë, pajtimi i njerëzve dhe i popujve, zhvillimi, bioetika dhe pikësëpari, paqja në nivel lokal e global. Ne kemi rënë dakord që të mos lejojmë idetë fundamentaliste të qarqeve ekstremiste të ndikojnë tek anëtarët e komuniteteve tona. Vizioni ynë nuk ka qenë thjesht toleranca fetare, por bashkekzistenca harmonike”.

Kryetari i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë Mons. Angelo Massafra në fjalën e tij ka

theksuar se, dëshira ime në lidhje me këtë çështje është që analiza e bërë nga Papa Françesku dhe Imami i Madh i al Az'harit, Shejh Ahmed Al-Tajjib, të bëhet objekt kërkimi, studimi dhe thellimi edhe këtu në tokën tonë, ku individualizmi dhe filozofitë materialiste përparojnë në mënyrë të pakontrolluar me pasojë humbjen e vlerave.

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve H. Dede Edmond Brahimaj tha ndër të tjera se, “vendim im, Shqipëria, ndonëse ka jetuar ngjarje të frikshme në vitet e komunizmit e më pas me vështirësitë e ringritjes në postkomunizëm, sigurisht ka diçka të bukur brenda vetes. Ka margaritarin e çmuar të modelit të harmonisë dhe bashkëjetesës fetare.

Ne liderët fetarë dhe besimtarë të zakonshëm, duke adhuruar me devocion Krijuesin, duke ruajtur dhe respektuar traditat fetare dhe atdhetare, i rrëfyem Evropës së qytetëruar, se pavarësisht stuhive të çfarëdollojshme, dashuria për Zotin, për njeri-tjetrin, mirëkuptimi dhe solidariteti fetar, mbeten si një xhevahir i mrekullueshëm në gjerdan të identitetit tonë.”



TË SHIKOHET DINJITETI NJERËZORE NË TË NJËJTËN MËNYRË SIÇ E SHEH KRIJUESI

**Fjalimi i Imzot Angelo Massafra-s
në forumin ndërfetar
Tiranë, 10 shkurt 2022**

Ju përshëndes të gjithë ju të mbledhur këtu për këtë ditë vëllazërie të shkëlqyer me të cilën dëshirojmë të nderojmë angazhimin për vazhdimin e dialogut rreth çështjeve që kanë dalë nga takimi historik në Abu Dabi, në vitin 2019, mes Papa Françeskut dhe Imamit të Madh të Al-Ahzar-it, Sheikut Ahmad Al-Tayyeb-i, takim ky që, tashmë, ka hyrë në histori; në përkujtim të 800-vjetorit të takimit të Shën Françeskut të Asizit me Sulltanin Al-Malik Al-Kamel-it në Damietë, në vitin 1219.

I yni është një detyrim moral që buron nga vetëdija e plotë, për fat të keq ende vetëm e disave, se religjioziteti i vërtetë e shikon dinjitetin e qenies njerëzore në të njëjtën mënyrë siç e sheh Krijuesi i tij; dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të vihet në rrezik në asnjë mënyrë, deri në atë pikë sa të pretendojë autonominë e vet, siç dëshiron të na bëjë të besojmë njëfarë humanizmi i caktuar.

E kam fjalën për pjesën e Dokumentit të Abu Dabit ku thuhet: *“Kjo Deklaratë, duke nisur nga një reflektim i thellë i realitetit tonë bashkëkohës, duke vlerësuar sukseset e tij dhe duke jetuar dhimbjet e tij, fatkeqësitë e tij dhe gjëmat, beson me ngulm se ndër shkaqet më të rëndësishme të krizës së botës moderne janë një ndërgjegje njerëzore e anestetizuar dhe largimi nga vlerat fetare, për më tepër edhe mbizotërimi i individualizmit dhe i filozofive materialistike që hyjnizojnë njeriun dhe vënë vlerat e botës dhe ato materiale në vend të parimeve të larta dhe transhendente.”*

Dëshira ime në lidhje me këtë çështje është që kjo analizë e bërë nga Papa Françesku dhe Imami i Madh i Al-Ahzar-i, Sheiku Ahmad Al-Tayyeb-i, së bashku me pjesët e tjera të Dokumentit, të bëhet objekt kërkimi, studimi dhe thellimi, edhe këtu në tokën tonë ku individualizmi dhe filozofitë materialiste përparojnë në mënyrë të pakontrolluar, me pasojë humbjen e vlerave laike, tipike të



popullit tonë shqiptar, që na përkasin dhe që tanimë po braktisen gjithnjë e më shumë.

Dhe meqenëse në këtë takim i kushtohet rëndësi jo vetëm brezave të rinj, dëshiroj ta mbyll fjalën time shumë të shkurtër duke cituar edhe një herë Dokumentin e Abu Dabit ku kërkohet *“që ky Dokument të bëhet objekt kërkimi dhe reflektimi në të gjitha shkollat, në universitete dhe në institutet e edukimit e të formimit, me qëllim që të kontribuohet për të krijuar breza të rinj që të sjellin të mirën dhe paqen dhe të mbrojnë kudo të drejtën e të shtypurve dhe të të fundmëve”*.

Kështu të behët “Pakt Edukativ Global”, për të cilën insiston Papa Françesku.

Mirëpres iniciativën më të re të propozuar nga UNHCR dhe Caritas Shqiptar, për të bashkepunuar me Keshillin Ndërfetar në fushën e Migracionit, ky le të jetë vazhdimi i një modeli vëllazërie, solidariteti, dhe uniteti që na fton të angazhohemi sëbashku edhe në mbrojtje të dinjitetit të çdo personi që është në kërkim të një jetë më të sigurve, siç janë refugjatet.

Ju uroj të gjithëve një vazhdim në paqe të këtij takimi së bashku me përshëndetjen e paqes, të përbashkët për besimet tona: *“I Gjithëpushtetshmi, i Amshueshmi, i Drejti dhe i Mëshirshmi Hyj”* (Shën Françesku i Asizit) e bekoftë angazhimin tonë në shërbim të paqes.



HISTORIA E SEMINARIT FILLON QË NË VITIN 1859

*30 vjetori i rihapjes së Seminarit Ndërdioqezan
Dom Leonardo Falco: Seminari Ndërdioqezan është zemra e Kishës në Shqipëri*

Shkodër, 2 janar 2022

Që prej vitit 2013, Dom Leonardo Falco është caktuar si Rektori i Seminarit Ndërdioqezan “Nëna e Këshillit të Mirë” në Shkodër. Në kuadër të 30 vjetorit të rihapjes së këtij Seminarit, i cili u mbyll në vitin 1947 nga diktatura komuniste, Dom Leonardo në një intervistë për portalin KISHA.AL, sesa meshtarë janë formuar në këtë seminar gjatë këtyre 30 viteve, se sa i rëndësishëm është për Kishën Shqiptare. Rektori Italian na flet për sfidat e së ardhmes, arsyet që sipas tij kanë çuar në tkurrjen e numrit të seminaristëve, por në fund ka edhe një mesazh për të rinjtë “Hapuni dyert e zemrës dhe pranoni Hirin e Zotit dhe fjalën e Zotit”.

Seminari feston 30 vjetorin e rihapjes, si e shikoni ecjen e tij në këto 30 vite dhe gjatë kohës që ju jeni në krye të tij si rektor?

Unë besoj që 30 vjet janë shumë, por edhe janë pak në krahasim me historinë e Seminarit, se historia e Seminarit fillon në vitin 1859, kur Jezuitët nga Italia kanë hapur Seminarin e parë në Shkodër, pastaj kemi pasur 45 vjet komunizëm që seminari ka qenë i mbyllur, me 7 Mars 1946, deri në vitin 1991 kur në Shqipëri, Kisha ka filluar të marrë organizimin e saj dhe me 2 shkurt 1992 është rihapur seminari. Nga viti 92' deri sot këtu në Seminar janë formuar gati 100 meshtarë, që kanë qenë këtu si seminarista, kanë marrë jo vetëm shkollën, por edhe formimin si meshtar ose janë rregulltarë, françeskanë, jezuitë, etj, që kanë studiuar në shkollën tonë. Kështu që unë besoj me pas 100 meshtarë të formuar këtu në Shqipëri nuk është pak, patjetër edhe vlerësimi është shumë pozitiv dhe besoj që aftësinë, angazhimin, zellin që kanë meshtarët shqiptarë tregon edhe që formimi që kanë marrë ka qenë i mirë.

Sa i rëndësishëm është ky seminar për Kishën Katolike në Shqipëri?

Ne në Itali kemi një shprehje “Seminari është zemra e çdo dioqeze”, tani Seminari është Ndërdioqezan është zemra e Kishës në Shqipëri, jo vetëm se këtu formohen meshtarë, kjo është edhe arsyeja kryesore e Seminarit, por sepse Seminari gjithmonë do të jetë një vend ku të gjitha anëtarët e Kishës, laikëve, rregulltar/rregulltare dhe meshtarët mund të gjejnë disa nisje për formimin e tyre, nga ana shpirtërore, nga ana katekistike.

Cilat janë sfidat e së ardhmes së këtij Seminarit?

Një problem që kemi, problem domethënë që na shqetëson e nuk na shqetëson që seminaristë janë pak. Kohët e fundit domethënë kemi këtë vit, vetëm 7 seminaristë, 3 janë nga Kosova, 3 nga Shqipëria dhe 1 shqiptar nga Mali i Zi. Arsyet cilat janë, pak a shumë e dimë që çdo djalë i ri shqiptar mendon vetëm emigrimin, tani ne



nuk mund të gjykojmë është mirë apo keq, situata është kështu, rënia e numrit të lindjeve, dëshira e familjeve shqiptare për të emigruar, por unë besoj edhe përdorimin e mjeteve të komunikimit jo të mirë, secili është gjithmonë më i izoluar dhe vetmuar dhe e kanë vështirë me pas një ndjenjë për me qenë i hapur ndaj thirrjes së Zotit, por në të njëjtën kohë besoj që nga ana kulturore, unë jam italian dhe më duket të rinjtë Italian janë edhe ma shumë të papërqendruar në aspektet fetare, shqiptarët kanë një predispozitë më shumë.

Sa ndikon mungesa e thirrjeve në vazhdimësinë e këtij Seminarit?

Në qoftë se ne e mendojmë Seminarin vetëm si vend ku formohen meshtarët tanë, patjetër duke rënë numri, do kemi vështirësi, por nëqoftëse ne mendojmë Seminarin si një vend ku çdo person për të jetuar mirë thirrjen e vet, angazhohet dhe ka mundësi për një formim nga ana shpirtërore, nga ana katekistike dhe nga ana teologjike, Seminari mund të vazhdojë përgjithmonë deri kur Kisha është e pranishme në Shqipëri duhet një vend formimi.

Pse gjithnjë e më shumë po tkurret numri i seminaristëve?

Arsyet janë që si fillim ka rënë numri i popullsisë, shqiptarët kanë dëshirë vetëm për të emigruar dhe kështu që është shumë e vështirë që një djali i ri në Shqipëri bën një projekt të jetës që e kushtëzon edhe për të ardhmen, sepse e ka mendjen për të emigruar, pastaj kur ai ka gjetur rehatinë e vet, mund të ketë vendosur, por ne kemi një fenomen tepër interesant, kemi shumë shqiptarë që kanë emigruar dhe atje ku kanë jetuar kanë hyrë në Seminar. Kështu nuk është e vërtetë që thirrje janë pak, por për arsye të emigrimit janë shpërndarë nëpër botë.

Thirrja apo mesazhi që keni për të rinjtë!

Seminari është rihapur 30 vjet më përpara dhe mua më pëlqen shumë një shprehje e Papa Gjon Palit II “Hapuni dyert e zemrës dhe pranoni Hirin e Zotit dhe fjalën e Zotit”, pastaj Zoti ka vetëm një qëllim për secilin prej nesh që është lumturia e jetës, si meshtarë, si i martuar, si rregulltarë/e, nuk ka rëndësi, por vetëm do të besoni që Zoti do vërtetë vetëm të mirën tonë.



Dom Nikë UKGJINI

FISHTA NDËRMJET STUDIMEVE NË BOSNJE DHE SKRIVANISË SË TIJ NË SHQIPËRI

Konferencë shkencore me rastin 150 vjetorit të lindjes të Atë Gjergj Fishtës, mbajtur në Shkodër, 15 dhjetor 2022, nga Universiteti i Shkodrës, sektori i gjuhës e letërsisë.

Situata problematike në vitet e Rilindjes Kombëtare, mesi i shek. të XIX, në Ballkan, si pasoje kishte pushtimet e egra shumë shekullore të trojeve arbërore nga osmanet. Jeta shoqërore, arsimimi e kultura në qytete kishin pësuar rrënimet totale, nga furia anadollake të cilët edhe me ligj e kishin ndaluar frymarrjen shpirtërore dhe mendore, të arbërorëve në trojet e tyre stërgjyshore. Kishat dhe manastiret katolike të vetmet institucione, ku behej edukimi dhe arsimimi i kufizuar i brezave të rinjë.

Mësuesit klerik organizonin mësimet fshehurazi nëpër shtëpi private. Mësimet shqip në këto shkolla i ndihmonte mjaft, puna e klerikëve arsimdashës për përgatitjen e teksteve dhe të materialëve të tjera mësimore në gjuhën shqipe. Këtë lloj misioni, e kanë kryer, klerikët shqiptar, nga Buzuku, e deri të Atë Gjergj Fishta.

Fishta talent i shkëlqyer

Përçapja e rikthimit të identiteti tonë kombëtar, nuk kishte si të mos e shqetësonte shpirtin, që në moshë të re klerikut poetit, shkrimtarit, mendimtari, veprimtari, të shquar atë Gjergj Fishta, i cili gjate rrugëtimit të gjatë e të mundimshme të tij, ka sjell horizontet e reja për rimëkëmbjen e historisë, kulturores, arsimit e gjuhës shqipe.

Shtyrja vendimtare që përgatiti ta ripërtërinte Provincën Françeskane Shqiptare që pa dyshim, hapja e Kolegjit të parë në Troshan në vitin 1880, ku mund të rriteshin e të mësonin të rinjtë vendas për misionin, fetar e kulturor në trojet shqiptare.

Në libri i të pagëzuarve të famullisë së Troshnit, mësojmë së Zefi u lind në Fishtë të Zadrimës më 22 tetor viti 1871 dhe u pagëzua me 24, dhjetor të atë viti, nga Atë Leonardo De Martino (1830-1823). Biografi i tij më i skrupullt, Atë Daniel Gjeçaj, jo rastësisht do e cilësonte Zefin e vogël që në moshën 6 vjeçare, si fëmije plotë jetë e gjallëri, i mbrehet i zgjuar, e i kuptueshëm, ndër dy vëllezërit të mëdhenj dhe motrën e tij.

Zefi, pra Gjergji i mëvonshëm, po kështu dallohej si talent i rrallë dhe sjellje shembullore



nder të pesë rishtaret e vet, të cilët pas mësimëve gjashtëvjeçare në Kolegjinë e Troshanit, nga viti 1886, kishin vazhduar mësimet e larta filozofike e teologjike së bashku me Fishtën, në Kraljevo Sutjeska, Gorica Livno, Kreshevo, në Bosnjë.

Meqenëse Bosnja e Hercegovina, pas qëndrimit të gjatë nën pushtimin osman, me Kongresi i Berlinit të vitit 1878, ishte vendosur nën administrimin e Austro-Hungarez, ky vend i lashtë Ilir edhe pse tani me shumicë të popullatës të islamizuar, do e mos do, kishte marr orientimin politike e kulturore perëndimor. Dërgimi i studentëve tanë për studime po atje, që një mundësi e artë që edhe mëtej ta zhvillonin gamen e diturisë, intelektuale e shpirtërore, për tu bërë meshtarë shqiptar të urdhrorit Françeskan, për të kryer misionin e tyre në Shqipëri.

Zefi, pra Gjergji si djali i vogël i Ndokes, i cili shpesh herë si në gaz do shprehej: *me ka ba nana me*



te mendueme, përgjatë studimeve të larta të viteve 1868-1893, në Provincën Minorite të Bosnjës, talentin e femërisë edhe matej do e zgjeronte e thellonte më njohje të reja në fushën, biblike, teologjike, juridike e letrare e gjuhësore.

Në arkivat e etereve françeskan në Bosnje, nga një mori emrash të studenteve kroatësh, të bie në sy, emri Joanes- Gjon (Ivo në gjuhen kroate) Fishta, i cili edhe pse vinte nga një vend i prapambetur për shkak të pushtimeve shume shekullor turke dhe ku shkollimi ishte molle e ndaluar, e mbante në vete, do të thosha, disa cilësi të veçanta në krahasim në studente shqiptar dhe ata vendas. Kjo gjë kuptohet fort mirë nga shfletimi i dokumentacionit shkollor, ku Fishta, rezulton nxënësi me i dalluar, i shkëlqyeshëm (Eminens), gjatë studimeve filozofike, në Kraljevo Sutjeska, në vitet 1888-1889, si dhe atyre teologjike, në Gorica-Livno, në vitet, 1889-1893. Si përmbledhje të gjitha mësimëve shkollor gjejmë dhe diplomën shkollore të Fishtës, lëshuar më dt. 6 shkurt vitit 1893 nga Komisioni përkatës, e gjejmë Fishtën si student të shkëlqyer.

Puna studimore e Fishtës, është vlerësuar lart edhe nga eprori i provincës të etereve françeskan në Bosnjës, Atë Andria Buzuk, i cili do shprehej se, kishte një konsideratë të madhe për te, duke e vlerësuar si një talent të madhe më një inteligjencë të jashtëzakonshëm.

Fishta, gjatë kohës studentore në Bosnjë, në vitet 1886-1893, nuk kishte si të mos e shprehte para studentëve boshnjakë dhe eprorëve të tij, krenarinë dhe njëherazi dhimbjen për atë çfarë po ndodhte me popullin e tij, i cili akoma dergjej nën pushtimin e perandorisë e osmane. Në shenje të mishnimit të heronjve të luftërave dhe të kulturës kombëtare, në kushtet e Përmotshme, në vitin 1891, ai, nga Jozef e më vonë Johannes (Gjon) kishte marr emrin, Enea-Silvio-Giorgio Fishta, përkatësisht, Georgius Fishta.

Fishta, fal Zotit, ishte një talent i lindur. Fara e këtij lloj gjeniu, mori zhvillimit e veta, duke u gjetur një tokë të pëlleshme e të begatshme, siç ishin ambientit studimore në Kolegjet e etereve françeskan në Bosnje, ku ia pati rasti të njihej më autoret e letërsisë së vjetër, latine, greke dhe italiane si: Dante, Goldoni, Manzoni, Pascoli. Në këto ambiente ku rritej dhe zhvillohej, patin dhe fatin e mirë, që të këtë për mësuës, rilindësit e spikatur të botës kroate si: Grga Martiq, Andria Kaçiq Mioçiq, etj. të cilët la gjurmë të thela jetësore, në shpirtin e shqiptarit, teologut, poeti, prozatorit, diplomatit, Atë Gjergj Fishta.

Fishta dhe skrivanija e tij në Atdhe

Rikthimi i tij në atdhe në vitin 1893, nga një vend si Bosnja nën Austro-Hungarinë dhe ballafaqimi drejtpërsëdrejti i Fishtës me pushtuesit osmanë dhe më vonë, serbët e malazezët, qenë faktorë përcaktues për te, që në programin e tij jetësor, krahas detyrave shpirtërore, ta ketë dhe çështjen rimëkëmbjes kombëtare.

Ngjarjet politike nëpër të cilat merrte shtat Shqipëria jetime, e shtynin Fishtën të rrinte përherë i zgjuar me pendë në dorë, e cila njëherazi shndërrohej në shigjetë të ngrehur, si ajo makabejane, “pro aris et focus”, për altar dhe vatër, e cila në gjuhën e Fishtës përkthehej: “për fe e atdhe”, moto e cila gjithë jetën e ka shoqëruar poetin tonë kombëtar.

Me shkrimet e tij të botuara në të përkohshmen 'Albania' (1900-1905), si: “Shcypja e burrit”; “Ma i madhi kob i shcyparis”, “Mali i Zi” etj., “Hylli i Dritës” nga viti i themelimit të saj 1913 e në vazhdim, “Posta e Shqypnis” (1917-1918) “Grueja Shqyptare” (1920), dhe revistën Jezuite “Leka”, (1929-1944) të paraqitura në formë proze, poezie, lirike, satire dhe dramaturgjike, Fishta, arrinte t'i shtrinte idetë e veta gjithmonë dhe gjithkund, në funksion të mbrojtjes dhe përparimit të atdheut.

Duke bërë letërsi, publicistikë, apologji, kritikë dhe mbi të gjitha polemikë, ka ndezur shkënditë e zjarrit në zemrat e shumë shqiptarëve, për ruajtjen e identitetit dhe dinjitetit njerëzor në tokën arbërore, të mbështetur në parimet biblike: “Ku është shpirti i Zotit, aty është liria”.

Me pendën e tij të artë dhe të zjarhtë, të mbështetur në drejtësi e liri, kulturë dhe përparim, arrinte t'i ndërgegjegjësonte shqiptarët nga indiferentizmi i kohës, dhe njëherazi të vërë në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare për zgjidhjen sa më objektive të çështjes së shqiptarëve në Ballkan.

Fishta u shua më 30 dhjetor 1940 në moshën 69-vjeçare. Ai, guxoi dhe beri një punë fort të admirueshme, akt që mundi të jetë dhe me mbeti si dëshmi e një talenti dhe dhuntie të pashoqe edhe si; diplomat, etnograf, arkeolog, hulumtues, muzikan, piktor, arkitekt, përkthyes, etj... Gjithkund ku ai vuri dorë, ngulmëu me zemër, shndriti me mendje, e shkrepiti me fjalë, ishte dhe mbeti një prej testeve ma të çmuar të identitetit tonë kombëtar.

*Botue në gazetën “Dielli”,
New York, 11. Janar 2022.*



DON EMILIO VALENTE
*Përgjegjës dioqezan
për Marrëdhëniet Ndërfetare*

TË KRISHTERËT THIRREN, TË JENË NJË SHENJË PËR BOTËN E ZOTIT *Java e lutjes për bashkim e të krishterëve, 2022*

Shkodër, Kisha Françeskut më 21 janar 2022.



Java e lutjes për bashkimin e të krishterëve është kthyer tashmë në një traditë e cila po përhapet çdo vit e më shumë në të katër anët e botës. Ndonëse zanafilla e kësaj jave është e vonë (fillim shek. XX), ajo nuk ka vonuar dhe është përqaftuar nga komunitete, kisha e kongregata të ndryshme nëpër botë, të cilat zhvillojnë takime lutjeje nga data 18 deri më 25 janar. Në vende të ndryshme gjatë kësaj jave organizohen aktivitete me të rinjtë, takime bashkëndarëse, vigjilje ekumenike si dhe momente të përbashkëta lutjeje. Çdo vit përzgjidhet një frazë apo citim nga Shkrimet si objekt reflektimi dhe meditimi gjatë kësaj jave. Këtë vit është marrë rreshti 2 i kapitullit të dytë të Ungjillit të Mateut “E pamë yllin e tij duke lindur, ndaj erdhëm t’i shprehim nderimet tona”. Ashtu siç magët e kanë lejuar veten e tyre të udhëhiqen nga ylli, ashtu edhe të gjitha kishat duhet t’i besohen plotësisht yllit të vërtetë në mënyrë që të arrihet bashkimi i dëshiruar. Organizimi dhe sistemimi i materialeve dhe argumenteve për këtë Javë i është besuar Këshillit të Kishave të Lindjes së Mesme me seli në Beirut, Liban.

Në vendin tonë, tashmë për disa vite radhazi, kjo Javë ka konsistuar në dy takime lutjeje, të cilat janë mbajtur në kishën e Shën Françeskut në Gjuhadol dhe në kishën e Lindjes së Krishtit në Shkodër. Këtë vit kremtimi ekumenik është organizuar në kishën e Shën Françeskut më 21 janar 2022. Udhëheqësi i këtij kremtimi ishte arqipeshkvi i Arqidioqezës Shkodër-Pult imzot Angelo Massafra, i cili në fjalën e tij falënderoi Zotin për mundësinë që jep për t’u lutur së bashku për bashkimin e të krishterëve dhe njëkohësisht

ftoi besimtarët të mos kenë frikë në këtë rrugëtim, por të kërkojnë gjithmonë forcën nga Zoti në mënyrë që një ditë ky ideal të bëhet realitet. I pranishëm në këtë kremtim ishte famullitari i kishës “Lindja e Krishtit” atë Nikolla Petani. Ai duke përsëritur dëshirën për të pasur një Kungim të përbashkët për kishat tona, vuri theksin në angazhimin që kërkohet nga secili besimtar për të arritur në këtë bashkim aq të dëshiruar, i cili mund të arrihet nëpërmjet përfshirjes aktive dhe lutjeve të vazhdueshme.

Kësaj radhe riti i këtij kremtimi ka qenë pak i ndryshëm prej viteve të tjera. Materiali udhëzues është përgatitur dhe publikuar nga Këshilli Papnor për promovimin e bashkimit të krishterëve, Komisioni për Besimin dhe Urdhri i Këshillit Botëror i Kishave. Në këtë kremtim kanë qenë të ndërthurura lexime, himne, lutje lavdërimi dhe këngë të ndryshme. Nuk mungoi prania e meshtarëve, besimtarëve, rregulltarëve e rregulltareve, të cilët janë bashkuar në këtë kremtim ekumenik për t’u lutur së bashku. Shoqërimin instrumental në këtë kremtim e bëri fra Luigi Aluisi, ndërsa për krejt aktivitetin për sa i përket pjesës organizative u kujdesua përgjegjësi për Ekumenizmin dhe Marrëdhëniet ndërfetare për Arqidioqezën e Shkodër-Pultit dom Emilio Valente.

Hyrje në temen për vitin 2022

“Sepse e pamë yllin e tij duke lindur ndaj erdhëm t’i shprehim nderimet tona!” (Mateu 2,2)

Sipas Ungjillit të Mateut (2,1-12), shfaqja e yllit në qiellin e Judesë, përfaqëson një shenjë të shumëpritur



të shpresës, që i çon magjistarët, si edhe vërtet të gjithë popujt e tokës, në vendin ku mbreti dhe Shpëtimtari i vërtetë zbulohet. Ky yll është një dhuratë, një tregues i pranisë së dashurisë së Zotit për të gjithë njerëzimin. Për magjistarët ishte një shenjë se kishte lindur një mbret. Me rrezet e tij, ai e çon njerëzimin drejt një drite më të madhe, Jezusit, dritës së re që ndriçon çdo person dhe që na çon në lavdinë e Atit dhe vezullimin e shkëlqimit të tij. Jezusi është drita që ka ardhur në errësirën tonë kur, me anë të Shpirtit të Shenjtë, ai u mishërua nga Virgjëra Mari dhe u bë njeri. Jezusi është drita që shkoj edhe më tej në errësirën e botës kur për hirin dhe shpëtimin tonë, ai e zbraz veten dhe u bë i bindur deri në vdekje. Ai e bëri këtë për të ndriçuar rrugën tonë drejt Atit, në mënyrë që ne të mund të njohim Atin dhe të njohim dashurinë që ai ka për ne, i cili dha Birin e tij të vetëm për ne, në mënyrë që duke besuar në Të të mos humbasim, por të kemi jetë të përvetshme.

Dijetarët panë yllin dhe e ndoqën atë. Tradicionalisht komentuesit kanë parë në figurat e Dijetarëve një simbol të larmisë së popujve të njohur në atë kohë dhe një shenjë të universalitetit të thirrjes hyjnore që shfaqet në dritën e yllit që shkëlqen nga lindja. Ata gjithashtu shohin në kërkimin e etur të Dijetarëve për mbretin e porsalindur, gjithë urinë e njerëzimit për të vërtetën, për mirësinë dhe për bukurinë. Njerëzimi ka qenë i etur për Zotin që nga fillimi i krijimit në mënyrë që t'i japë atij nderim. Ylli u shfaq kur fëmija hyjnor lindi në plotësinë e kohës. Ai lajmëroi veprimin e shumëpritur të shpëtimit të Zotit, i cili fillon në misterin e mishërimit.

Dijetarët na zbulojnë unitetin e të gjitha kombeve të dëshiruara nga Zoti. Ata udhëtojnë nga vendet e largëta dhe përfaqësojnë kultura të ndryshme, megjithatë ata janë të shtyrë nga e njëjta uri për të parë dhe njohur mbretin e porsalindur, dhe mblidhen në shtëpinë e vogël në Betlehem në veprimin e thjeshtë të nderimit dhe ofrimit të dhuratave. Të krishterët thirren, të jenë një shenjë për botën e Zotit që sjell këtë unitet që ai dëshiron. Të tërhequr nga kultura, raca dhe gjuhë të ndryshme, të krishterët ndajnë një kërkim të përbashkët për Krishtin dhe një dëshirë të përbashkët për ta adhuruar atë. Misioni i popullit të krishterë, pra, është të jetë një shenjë si ylli, të udhëheqë njerëzimin në urinë e tij për Perëndinë, të çojë të gjithë te Krishti dhe të jetë mjeti me të cilin Zoti po sjell unitetin e të gjithë popujve.

Pjesë e aktit të adhurimit të Dijetarëve është hapja e thesareve të tyre, ofrimi i dhuratave të tyre, të cilat që nga lashtësia e krishterë, janë kuptuar si shenja të aspekteve të ndryshme të identitetit të Krishtit: ari për mbretërinë e tij; temjan për hyjninë e tij; dhe mira parashikonte vdekjen e tij. Dhuratat e ndryshme, kësisoj, na japin një imazh të njohurive të veçanta që kanë traditat e ndryshme të krishtera në personin dhe veprën e Jezusit. Kur të krishterët mblidhen së bashku

dhe hapin thesaret dhe zemrat e tyre në nderim të Krishtit, të gjithë pasurohen ndërsa dhuratat e këtyre njohurive ndahen.

Ylli u ngrit në lindje (Mt 2,2). Nga lindja lind dielli dhe nga ajo që quhet Lindja e Mesme, shpëtimi u shfaq me mëshirën e Perëndisë sonë, që na bekoj me agimin nga lart (Luka 1,78). Por historia e Lindjes së Mesme u karakterizua dhe ende është, e karakterizuar nga konflikti dhe grindjet, e njollosur me gjak dhe e errësuar nga padrejtësia dhe shtypja. Kohët e fundit, që nga *Nakba* Palestineze (eksodi i popullsisë arabe të Palestinës gjatë luftës së 1948) rajoni ka parë një seri luftërash dhe revolucioneve të përgjakshme dhe rritjen e ekstremizmit fetar. Historia e Dijetarëve përmban gjithashtu shumë elementë të errët, veçanërisht urdhrat despotikë të Herodit për të masakruar të gjithë fëmijët rreth Betlehemit që ishin më pak se dy vjeç (Mt 2,16-18). Mizoria e këtyre tregimeve rezonin me historinë e gjatë dhe të tashmen e vështirë të Lindjes së Mesme.

Ndodhi në Lindjen e Mesme që Fjala e Zotit zuri rrënjë dhe dha fryte: tridhjetëfish, gjashtëdhjetëfish e njëqindfish. Dhe nga kjo lindje u nisën apostujt për të predikuar Ungjillin deri në skajet e tokës (Veprat 1,8). Lindja e Mesme dha mijëra dëshmitarë dhe martirë të krishterë. E megjithatë tani, vetë ekzistenca e komunitetit të vogël të krishterë kërcënohet pasi shumë janë të shtyrë të kërkojnë një jetë më të sigurt dhe të qetë diku tjetër. Ashtu si drita që është fëmija Jezus, drita e Krishterimit të Lindjes së Mesme po kërcënohet gjithnjë e më shumë në këto kohë të vështira.

Jeruzalemi është një simbol i fuqishëm për të krishterët sepse është qyteti i paqes ku i gjithë njerëzimi u shpëtua dhe u shëlbua. Por sot paqja i mungon qytetit. Palë të ndryshme vënë në dyshim pretendimin e tyre për këtë dhe nuk i marrin parasysh të tjerat. Edhe lutja në Jeruzalem i është nënshtruar masave politike dhe ushtarake. Jeruzalemi ishte qyteti i mbretërve, me të vërtetë qyteti ku Jezusi do të hynte triumfalisht, i lavdëruar si mbret (Lk 19,28-44). Natyrisht, Dijetarët prisnin të gjenin mbretin e sapolindur të zbuluar nga ylli në këtë qytet mbretëror. Sidoqoftë, tregimi na thotë se, në vend që të bekohej nga lindja e mbretit të Shpëtimtarit, i gjithë Jeruzalemi u zhyt në trazira, të cilat vazhdojnë edhe sot.

Sot, më shumë se kurrë, Lindja e Mesme ka nevojë për një dritë qiellore për të shoqëruar njerëzit e saj. Ylli i Betlehemit është një shenjë që Zoti ecën me njerëzit e tij, ndjen dhimbjen e tyre, dëgjon klithmat e tyre dhe tregon dhembshuri ndaj tyre. Na siguron se ndonëse rrethanat ndryshojnë dhe katastrofa të tmerrshme mund të ndodhin, besnikëria e Hyjit është e patundur. Zoti as nuk dremit as nuk fle. Ai ecën pranë njerëzve të tij dhe i kthen kur ata janë të humbur ose në rrezik. Rrugëtimi i besimit është kjo ecje me Perëndinë që kujdeset gjithmonë për popullin e vet dhe që na udhëheq në shtigjet komplekse të historisë dhe jetës.

Për këtë javë lutjeje, të krishterët e Lindjes së



Mesme zgjodhën temën e yllit që u ngrit në lindje për një numër arsyes. Ndërsa shumë të krishterë perëndimorë festojnë Krishtlindjet, festa më e lashtë dhe akoma festa kryesore e shumë të krishterëve lindorë, është Epifania kur shpëtimi i Zotit u zbulohet kombeve në Betlehem dhe në Jordan. Ky fokus në teofaninë (deftimi) është, në njëfarë kuptimi, një thesar që të krishterët e Lindjes së Mesme mund t'u ofrojnë vëllezërve dhe motrave të tyre në të gjithë botën.

Ylli i çon Dijetarët nëpër rrëmujën e Jeruzalemit ku Herodi planifikon vrasjen e jetës së pafajshme. Ende edhe sot, në pjesë të ndryshme të botës, të pafajshmit vuajnë dhunën apo kërcënimin e dhunës, ku familjet e reja ikin nga tiranët si Herodi dhe Augusti. Në këtë kontekst njerëzit kërkojnë një shenjë se Zoti është me ta. Ata kërkojnë mbretin e posalindur, mbretin e butësisë, paqes dhe dashurisë. Por ku është ylli që të çon rrugën tek Ai? Është misioni i Kishës të jetë ylli që ndriçon rrugën drejt Krishtit që është drita e botës. Duke qenë një yll i tillë Kisha bëhet një shenjë shprese në një botë telashesh dhe një shenjë e pranisë së Zotit me popullin e tij, duke i shoqëruar ata përmes vështirësive të jetës. Me fjalë dhe me vepra të krishterët thirren të ndriçojnë udhën në mënyrë që Krishti t'u zbulohet, edhe një herë, kombeve. Por ndarjet mes nesh e zbehin dritën e dëshmisë së krishterë dhe e errësojnë rrugën, duke i penguar të tjerët të gjejnë rrugën drejt Krishtit. Anasjelltas, të krishterët të bashkuar në adhurimin e tyre ndaj Krishtit dhe hapja e thesareve të tyre me shkëmbime dhuratash, bëhen shenjë të unitetit që Zoti dëshiron për të gjithë krijimin e tij.

Të krishterët e Lindjes së Mesme i ofrojnë këto burime për Javën e Lutjes për Njëshmërinë e të Krishterëve të vetëdijshëm se bota bashkëndan shumë nga mundimet dhe vështirësitë që ata përjetojnë dhe dëshirojnë që një dritë të çojë rrugën drejt Shpëtimtarit që mund të kapërcejë errësirën. Pandemia globale COVID-19, kriza ekonomike që pasoi dhe dështimi i strukturave politike, ekonomike dhe sociale për të mbrojtur më të dobëtit dhe më të prekshmit, kanë nënvizuar nevojën globale për një dritë që të ndriçojë në errësirë.

Ylli që shkëlqeu në lindje, Lindjen e Mesme, dy mijë vjet më parë, ende na thërret në grazhd, aty ku ka lindur Krishti. Ai na tërheq atje ku Shpirti i Zotit është gjallë dhe aktiv, në realitetin e pagëzimit tonë dhe në transformimin e zemrave tona.

Pasi takuan Shpëtimtarin dhe e adhuruan së bashku, Dijetarët kthehen në vendet e tyre në një mënyrë tjetër, pasi ishin paralajmëruar në ëndërr. Në mënyrë të ngjashme, bashkimi që ndajmë në lutjen tonë së bashku duhet të na frymëzojë që të kthehemi në jetën tonë, kishat tona dhe botën tonë në mënyra të reja. Udhëtimi me mënyra të reja është një ftesë për pendim dhe përtëritje në jetën tonë personale, në kishat tona dhe në shoqëritë tona. Ndjekja e Krishtit është rruga jonë e re,

dhe në një botë të paqëndrueshme dhe në ndryshim të krishterët duhet të mbeten të fiksuar dhe të vendosur si plejadat (constelacionet yjore) dhe planetët ndriçues. Por çfarë do të thotë kjo në praktikë? Shërbimi i Ungjillit sot kërkon një angazhim për të mbrojtur dinjitetin njerëzor, veçanërisht tek më të varfërit, më të dobëtit dhe të marginalizuarit. Ajo kërkon nga kishat transparencë dhe llogaridhënie në trajtimin e botës dhe njeri - tjetrin. Kjo do të thotë që kishat duhet të bashkëpunojnë për të siguruar ndihmë për të pikëlluarit, për të mirëpritur të shpërgulurit, për të lehtësuar barrën dhe për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të ndershme. Kjo është një thirrje që kishat të punojnë së bashku në mënyrë që të rinjtë të mund të ndërtojnë një të ardhme që i përshtatet zemrës së Zotit, një të ardhme në të cilën të gjitha qeniet njerëzore mund të përjetojnë jetë, paqe, drejtësi dhe dashuri. Mënyra e re midis kishave është rruga e unitetit të dukshëm që ne kërkojmë me sakrificë, guxim dhe kurajo, në mënyrë që, ditë pas dite, "Zoti të jetë gjithçka tek të gjithë" (1Kor 15.28)

Përgatitja e materialit për javën e lutjes për njësimin e të krishterëve, 2022

Grupi ndërkombëtar, i mbështetur bashkarisht nga Këshilli Papnor për Nxitjen e Bashkimit të Krishterëve (KPNBK) dhe Komisioni i Besimit dhe Urdhrit të Këshillit Botëror të Kishave për të përgatitur Materialet e Javës së Lutjes për Njëshmërinë e Krishterë 2022, nuk ishte në gjendje të takohej ballë për ballë këtë vit për shkak të pandemisë aktuale, dhe për këtë arsye i u desh të punonte në këto tekste nga distanca.

KPNBK ia besoi Këshillit të Kishave të Lindjes së Mesme me qendër në Bejrut, Liban, detyrën e zgjedhjes së temës dhe përgatitjen e teksteve për Javën e Lutjes 2022. Ata zgjodhën temën, "*Sepse e pamë yllin e Tij duke lindur ndaj erdhëm t'i shprehim nderimet tona!*" (Mt 2,2). Më shumë se kurrë, në këto kohë të vështira, ne kemi nevojë për një dritë që shkëlqen në errësirë dhe ajo dritë që të krishterët shpallin, është shfaqur në Jezu Krishtin.

Në një rajon të botës ku të drejtat e njeriut zakonisht shkelen dhe nëpërkëmben nga interesat e padrejta politike dhe ekonomike, përballë një krize të paparë ndërkombëtare shëndetësore dhe që mbart pasojat njerëzore dhe materiale të shpërthimit të rëndë që shkatërroi Bejrutin më 4 gusht 2020, grupi ekumenik lokal megjithatë bëri çdo përpjekje për të paraqitur rezultatet e punës së tij duke marrë pjesë në takimet online.

Ne i falënderojmë me gjithë zemër dhe lutemi që uniteti më i madh mes të krishterëve në Lindjen e Mesme dhe në mbarë botën të kontribuojë në një jetë më dinjitoze, të drejtë dhe paqësore për të gjithë burrat dhe gratë në kohën tonë dhe në kohët që vijnë.



PAPA FRANÇESKU FLET PËR DIALOGUN MES BREZAVE

Prezantimin e mesazhit të paqes, në teatrin Migjeni
10/01/2022

Të dashur autoritete civile dhe fetarë!

Kam kënaqësinë t'ju përshëndes në këtë mbrëmje të mrekullueshme, e cila, si zakonisht, çdo vit organizohet në bashkëpunim me Zyrën Dioqezane të Drejtësisë dhe Paqes, të cilën dëshiroj ta falënderoj menjëherë. Falënderoj Kryetaren e Bashkisë dhe Drejtoreshën e Teatrit.

Mesazhi që Papa Françesku donte të na dërgonte për Ditën Botërore të Paqes 2022, këtë vit shoqërohet me kremtimin e 25-vjetorit të shërbimit tim ipeshkvnor. Kjo rastësi e bukur më prek veçanërisht sepse temat e trajtuara nga Papa në Mesazh janë edhe filli i përbashkët (ligt motiv), gati-gati janë edhe slogani i mbarështimit tim në këto 25 vite.

Kur Françesku flet për Dialogun mes brezave, nuk mund të mos kujtoj angazhimin tim ndaj ndjenjës së përgjegjësisë së ndërsjellë, të cilën e kam nxitur gjithmonë, gati përherë duke përdorur fjalët: "*Shqiptari duhet të jetë solidar me vëllanë e tij shqiptar*". Dhe kjo në një kuptim të gjerë, si në kuadrin e bamirësisë, ashtu edhe në atë të kujdesit për të moshuarit, të dobëtit dhe të pambrojturit. Sot më shumë se kurrë ky dialog mes brezave duhet të gjejë mënyrën që të rimerret, sot që më të rinjtë dhe më energjikët synojnë të braktisen këtë tokë e dashur dhe, bashkë me të, edhe prindërit e destinuar të mbeten vetëm.

Dhe ndërsa Papa flet për edukimin, nuk mund të mos më dalë përpara syve angazhimi i madh i Kishës katolike për formimin kulturor të brezave të rinj përmes institucioneve që janë krijuar tash e tridhjetë vjet, falë edhe angazhimit të famullive, të instituteve rregulltare mashkullore dhe femërore. Papa na tha se ai i edukimit duhet të konsiderohet më shumë si investim sesa si shpenzim; dhe ne kemi bërë pikërisht kështu: kemi investuar shumë dhe frytet janë të dukshme prej të gjithëve. Shpresoj që edhe në nivel politik të merret seriozisht ky sugjerim i Papa Françeskut dhe të zbatohet pa iu hequr asnjë presje.

Në fund puna, thotë Papa Françesku: "*është baza mbi të cilën ndërtohet drejtësia dhe solidariteti në çdo komunitet*"; dhe e kontekstualizon këtë fjali në përshkrimin se si pasiguria në



punë dhe padrejtësitë shoqërore janë shkak jo vetëm i vështirësive dhe i varfërisë, por edhe i dhunës dhe i krimit. Shumë shpesh e kam ngritur zërin gjatë këtyre viteve (ndonjëherë i mbështetur edhe nga krerët e besimeve të tjera fetare) për ta denoncuar këtë pasiguri dhe për t'i nxitur institucionet që të mbajnë qëndrimin e duhur. Sot, kriza botërore, e përforcuar edhe nga pandemia, nuk mund të jetë një alibi për të mos siguruar mirëqenien sociale të vendit; jo vetëm të atyre që janë mirë dhe vazhdojnë ta rrisin mirëqenien e tyre, por të të gjitha shtresave shoqërore, duke garantuar paga të drejta, përkujdes shëndetësor për të gjithë (jo vetëm për ata që mund ta përballojnë). Nga ana tjetër, nuk mund të hesht kur dëgjoj për punë të refuzuara, për një tokë që mbetet djerrë, sepse pak kush dëshiron ta punojë atë (por pastaj shkojnë e punojnë jashtë!). Është e vërtetë që institucionet mund dhe duhet të bëjnë më shumë, por është gjithashtu e vërtetë që të gjithë duhet të bëjnë pjesën tone dhe të angazhohemi për një Shqipëri më të mirë.

Shumë të dashur, ju falënderoj sërish për praninë tuaj dashamirëse dhe për afërsinë tuaj në këtë moment feste për qytetin e Shkodrës dhe për mua. Ju uroj të gjithëve një Vit të Ri të mbushur me paqe, me harmoni, me shëndet dhe me çdo bekim nga Hyji i gjithëpushtetshëm.

Faleminderit

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkev



KISHA KATOLIKE ITALIANE IA KA SHTRIRË DORËN SHQIPËRISË

*Përhëndetja e Imzot Angelo Massafra-s,
me rastin e dekorimit të Karitasit Italian
Tiranë, 8 shkurt 2022*

Zoti President i Republikës,
në emrin tim personal, në emër të ipeshkvijve të Shqipërisë, të krejt Kishës Katolike dhe të të gjithë shqiptarëve që janë ndihmuar falë solidaritetit të Kishës Italiane, Ju falënderoj për mirënjohjen Tuaj të shprehur përmes dhënies së dekoratës “NËNË TEREZA” Karitasit Italian në personin e drejtorit të saj të ri, Dom Marco Pagniello-s.

Mirënjohja Juaj përkon me 50-vjetorin e themelimit të Karitasit Italian dhe me 30-vjetorin e pranisë së tij në Tokën e Shqiponjave, duke themeluar dhe duke mbështetur Karitasin Shqiptar me të cilin bashkëndan programe, rrugëtime dhe projekte.

Siç e dini, Karitasi Italian është mjete nëpërmjet të cilit Kisha Katolike Italiane ia ka shtrirë dorën Shqipërisë në kohë vështirësish për të bërë ndërhyrjen e saj sociale dhe humanitare.

Në këto 30 vite Karitasi Italian ka bashkëpunuar ngushtë me Karitasin Shqiptar, së bashku me qindra priftërinj dhe motra, misionare në këtë tokë të bukur, duke sjellë në Shqipëri mijëra laikë, të cilët, në këtë mënyrë, kanë njohur, kanë shoqëruar dhe kanë mbështetur Shqipërinë, duke marrë shumë miqësi dhe vëllazëri në këmbim.

Një "faleminderit" i përzemërt dhe i detyrueshëm shkon për Karitasin Italian dhe për të gjitha dioqezat italiane edhe për mikpritjen që i kanë bërë, që nga viti 1991 e deri më sot, mijëra emigrantëve shqiptarë që sot janë integruar ose po integrohen aty.

Ende sot Karitasi Italian bashkëpunon me Karitasin Shqiptar për t'iu përgjigjur nevojave të shumta të vendit dhe të popullsisë vendase, e cila jeton ende në mjerim, me një shkallë të lartë papunësie, veçanërisht tek të rinjtë, dhe me një emigracion të fortë. Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale që kanë ndodhur në Shqipëri ndër vite kanë mundësuar

një zhvillim të vullshëm ekonomik të vendit, por në të njëjtën kohë kanë rënduar situatën e brishtë të shumë familjeve.

Janë të shumta familjet, të rinjtë dhe të miturit që largohen nga vendi. I veçantë është fenomeni i të miturve të pashoqëruar. Lidhur me këtë, më lejoni të shpreh bindjen time personale: shpërngulja e të miturve të pashoqëruar nga Shqipëria është e pajustificueshme. Para së gjithash sepse kombi ynë, në këtë mënyrë, mbetet i varfëruar nga burimet e tij jetësore, që, më përpara se atyre natyrore, janë qytetarët e saj dhe sidomos më të rinjtë, ato që duhet të jenë e ardhmja e vendit. Po ashtu, besoj se ky lloj migrimi përbën gjithashtu një rrezik serioz duke qenë se të miturit e pashoqëruar mund të bien viktima të botës së krimit ose të trafikimit të njerëzve.

Zoti President, dje kemi qene ne Laç-Kurbini, duke dorëzuar tri familjeve çelësat e shtëpive të ndërtuar me financime të Karitasit Italian dhe disa do të jenë gati sa më shpejt.

Zoti President, faleminderit për këtë mirënjohje të bukur.

Dom Marco, këtë falënderim tonin çoja Karitasit Italian për atë që ka bërë në favor të kësaj toke. Por, ne kemi ende nevojë për ju dhe jemi të sigurt se nuk do të na lini vetëm. Faleminderit të gjithëve ju këtu të pranishëm.





DETYRA PARËSORE E DIAKONIT ËSHTË SHËRBIMI

**Me shtrirjen e duarve të Imzot Angelo Massafra,
Kisha jonë është pasuruar me pesë Diakonë të rinj!**

Dëgjohet shpesh në Kishën katolike të flitet për terma të tillë si “diakon” ose “shugurim diakonal”. Këto nocione përdoren vazhdimisht në diskutet tona, nganjëherë ndoshta edhe pa ditur saktësisht kuptimin dhe domethënien e tyre. Sikur të shtrohej pyetja “Kush është diakoni dhe çfarë funksioni ka ai?” të shumtë do të ishin ata që do ta konsideronin atë thjesht si një anëtar të klerit, i cili është në përgatitje për t'u shuguruar meshtar. Të qenurit diakon e tejkalon këtë mënyrë të konceptuarit thjesht si një pjesëtar i hierarkisë kishtarë. Kuptimin më të saktë të këtij termi e gjejmë në vetë etimologjinë e fjalës “diakon”, që vjen nga greqishtja (διάκονος – diákonos) dhe do të thotë shërbyes. Pra detyra parësore e diakonit është shërbimi. Nga kjo pastaj rrjedhin edhe të gjitha funksionet e tjera. Sigurisht, nuk është vetëm diakoni që është i thirrur të shërbejë, por ai duhet ta bëjë këtë gjë në mënyrë të domosdoshme dhe tërësisht të veçantë, duke shpallur Lajmin e gëzueshëm dhe duke dhënë një dëshmi të vërtetë dashurie, mirësie dhe dhembshurie.

Marrja e shërbesës së diakonatit nuk është një



gëzim vetëm për personin që e merr atë, por për krejt familjen, bashkësinë dhe dioqezën.

Një gëzim të tillë ka përjetuar Provinca françeskane shqiptare “Zoja Nunciatë”, e cila është pasuruar me tre diakonë të rinj: fra Jak Kolgjeraj, fra Valentin Tinaj dhe fra Kristjan Camaj. Shugurimi diakonal është bërë në ditën e festës së Zojës së Papërlyer, më 08.12.2021, datë në të cilën dy prej diakonëve (fra Valentin Tinaj dhe fra Kristjan Camaj) kanë mbushur një vit që nga kushtimi i përjetshëm rregulltar në familjen françeskane.

Ndërsa me 12 dhjetor 2021 në festën e Zojës së Guadalupe duke qenë se Mons. Ottavio Vitale ishte i sëmurë, Mons. Angelo Massafra ka shuguruar diakon edhe akolitin Erasmo David Gonzales i lëvizjes Neokatekumenale nga Dioqeza e Lezhës.

Ndërsa me rastin e festës së Shën Shtjefnit protomartir, pajtorit të Arqidioqezës Shkodër-Pult dhe të Katedrales, me 29 dhjetor 2021 është shuguruar diakon akoliti Marjan Gjinesha nga famullia e Boriçit.

Fra Lorenc Pepniku



NDAHET NGA JETA KLERIKU QË U DËNUA PËR POEZI!
Dom Gjergj Simoni
(1933 - 2022)

*Është ndarë nga jeta, me dt. 29 janar 2022,
një ndër klerikët që vuajti 9 vjet e 20 ditë burgim gjatë regjimit, Dom Gjergj Simoni.*




Dom Gjergj Simoni, (Hardhia) u lind në Shkodër më 08.12.1933, nga baba Kolë e nëna Gjyste Simoni, në një familje qytetare shkodrane. I rritur në një mjedis katolik e me prindër të devotshëm fetarë. Që në moshë të vogël, ka pasur thirrje të brendshme për t'ju kushtuar Zotit, e cila me kalimin e viteve ka ardhur duke u shtuar pa pasur asnjë lëkundje. Duke qenë se Kisha Katolike në Shqipëri pësoi persekutime që në ditët e para të ardhjes së komunizmit, mbylljen e seminarit, nxjerrjen e motrave prej kuvendeve, arrestimin e pothuajse e të gjithë meshtarëve dhe pushkatimin e shumë prej tyre,

me këtë rast dom Gjergji u detyrua që t'i bënte studimet për meshtar në mënyrë të fshehtë. Sipas dëshmisë si tij, formimin e mesëm e mori nën kujdesin e françeskanëve, ndërsa formimin teologjik e mori nga Atë Mark Harapi S.J., e Atë Aleks Baqli O.F.M.

Gjatë viteve të mëvonshme ka punuar punë të ndryshme, si punëtor në hidrocentralin e Vau Dejës në mesin e viteve 60 dhe në kooperativën bujqësore të Bushatit. Por në të shumtën e viteve punoi si punëtor krahu deri në gushtin e vitit 1976. Dom Gjergji, me 30. 8. 1976 u arrestua nga forcat e Sigurimit





dhe duke ia kontrolluar banesën i gjetën të groposura libra të zgjedhura të ipeshkvisë, objekte të shenjta, shkrime të vëllait të tij Imzot Zef Simonit dhe disa poezi të thjeshta të shkruar në vitet 1958 -1975, për çfarë u akuzua për agjitacion e propagandë në bazë të nenit 73/1 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Shkodër, natën e Pashkëve, e akuzoj për agjitacion e propagandë dhe me vendimin nr.78, datë 9.4.1977, e deklaroi fajtor duke e dënuar me maksimumin e masës, 10 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e të drejtës zgjedhore për 5 vjet. Ai i vuajti 9 vjet e 20 ditë burgim gjatë regjimit komunist.

Sipas dëshmisë se vet Dom Gjergjit, në arkën e fshehur kishte pasur edhe dorëshkrimet e Atë Mark Harapit S.J., të Atë Benedikt Demës, si dhe qindra vjersha dhe poezi të shkruara gjatë viteve prej tij. Midis

tyre dallohet poema satirike me titull "Letra e Luciferit drejtuar popullit shqiptar, ku në fund ka vendosur shënimin: Luçiferri - Enver Hoxha.

U lirua nga burgimi më 20.9.1985., pas kalvarit që e shoqëroi në tre kampe burgu; Ballsh, Qafë e Barit dhe Spaç. Mbas muajve të lirimt ka hyrë në punë si punëtor i thjeshtë dhe ka punuar kështu deri në muajt e para të vitit 1991. Me ardhjen e lirisë së fesë në Shqipëri, dom Gjergji, u shugurua meshtar më 21. prill 1991 në katedralen e Shkodrës, ende të pa rekonstruktuar, nga Mons. Nikollë Troshani në moshën 58 vjeçare. Ishtë meshtar i parë i

shuguruar mbas mbylljes së kishave.

Për një vit ka shërbyer në qytetin e Shkodrës dhe më pas është emëruar famullitar i Dajçit të Bregut të Bunës dhe administrator i famullisë Pentarit gjatë viti 1992-2009

Përveç shërbimeve fetare të përditshme, është marrë edhe me sistemimin vëllimeve me poezi gjithashtu ka shkruar tregime të shkurtra me kujtime nga koha në burg dhe botoi vëllimin "Lule e gjak", "I burgosi vetëm koha".

Vdiq në moshën 89 vjeçare dhe Mesha e salikimit u zhvillua me dt. 29.01.2022, në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër. U varros në praninë e shumë meshtarëve dhe besimtarëve, me dt. 30. 02, në kriptën e meshtarëve në kapelën e varrezave të Rremajt në Shkodër.

Dom Vlash Palaj



NJË JETË ME DINJITET E RESPEKT PËR TË GJITHË

“Unë jam ringjallja dhe jeta, kush beson në mua edhe nëse vdes jeton”. Gjn 1, 25.

Me datën 02. 01. 2022, ndërroi jetë në moshën 92 vjeçare, Moter, Maria Koleta

Motër Maria Kaleta lindi me 10 nëntor 1929 në lagjen Sumaj-Nënshat, ishte fëmija i vetëm, mbesa e të Lumit Martirë Dom Ndoc Sumës. Qe në fëmijëri kishte dëshirë për uratë dhe lutje e mësuar prej axhes së saj meshtarë. Hyri në Kuvendin e Motrave Stigmatine, në moshën 10 vjeçe, e mirëpritur nga Provincialja Motër Konsilia Muzhani.

Me bindjen e plotë të saj, me vullnetin e Zotit mendoi se kjo derë e Motrave ishte për të 'Parriz toke'. Në vitin 1946, u mbyll Kuvendi i Motrave, sepse ashtu i erdhi terezia Shqipërisë, që mbyllej për ta dashur Zotin në fshehtësi, dhe Mt Maria sikur të gjitha tjerat kandidate u detyrua të kthehet në vendin e vet.

Pas pak kohësh axhën e saj Meshtar e arrestuan dhe pati pasoja të ndryshme për të dhe për familjen e saj, të cilët jetonin në fshatin Pistull të Zadrimes për të qenë më afër Dom Ndocit, ku ai shërbente si famullitarë.

Motër Maria ishte shumë e re, por me një urti të jashtzakonshme, një motër puntore, me përshtirëri të madhe, e palëkundur në besim në Zotin. Pasi ndërjuan jetë prindërit e saj, e pasi ishte fëmija i vetëm, përballoi më fisnikëri shumë vuajtje, vetmin dhe varfërin.

Me ndihmën e Zotit dhe mbështetjen e njërezve të fshatit Pistull, jetoi me dinjitet e respekt për të gjithë. Populli Pistull-Paçram, aq shumë e respektoi dhe e deshti sa që e thërret “halla Marije”, e cila i rriti në besim, i këshillonte në të mirë. Nga ky vend ka deri tani 6 thirrje të reja, ndër to dy meshtarë, Dom Simon Kulli sot Ipehskëv e Dom Marian Lumçi, famullitar sot në Katedralen e Shën Palit Tiranë.

Vlen ta theksojmë, kishte një devocion të veçantë ndaj Eukaristisë.

Forcën për të rezistuar dhe për ta ruajtur thirrjen gjatë viteve të provës, pra të rregjimit e ka gjetur në praninë reale të Jezusit, të cilin e ruante në shtëpi, “si Mikun më të mirë dhe më të nderuar”. Në bashkëpunim me motrat tjera stigmatine, sidomos mt Adelajden Pashkja e mt Gjorgjinen Bulgareci, kanë përgaditur oste për t'i shuguruar nga meshtarët që ishin në burgje, për t'ua dhënë pastaj të sëmunnrëve në familje e në spitale, meshtarëve në burgje, Motrave që e pritnin në fshehtësi.

Motër Maria nuk hezitoi edhe në dhënien e Sakramenteve tjera: Pagëzim, Kungim. Të gjithë e njohim dëshminë e veçantë të saj; ku ajo duke marrë ujin e kanalit me opingën e vet, pagëzoi dy vajza



“Mirela e Arta”, nga Maba, sepse feja e tyre ishte e madhe. Po ashtu, gjatë regjimit komunist ka pagëzuar, me kërkesë të familjes edhe Simon Kullin, sot Ipehskëv i Sapës.

Edhe pse ishte kandidate më dëshirë për jetën e kushtuar munda të bëjë shumë gjëra për ta mbajtur gjallë fenë e njerëzve. “Më të vërtetë populli ishte i uritur për Hyjin dhe unë isha e vetëdijshme se shërbimi im i fshehtë ua shuante atyre këtë uri,” dëshmoi ajo.

Hyji befason gjithmonë e nuk harron asgjë, Ai i mbushi zemrat e të vuajturve më gëzim.

Mt Maria si mbarë kisha shqiptare e bëri këtë përvojë mrekullie, kur në vitin 1990-91 u rikthye liria e fesë, liria e veprimt, liria e ungjillzimit.

Kur me 17 shtator 1991, ditën e Varrëve të Shenjta të Shën Françeskut, iu kushtua përsëri Zotit dhe filloi jetën e përbashkët, që aq shumë e kishte dëshiruar.

Motër Maria është martirja e gjallë, që dëshmoi para Papa Françeskut për sakrificat e saj gjatë regjimit komunist: “Zoti më gëzoi e më dha më



shumë seç prisja. Kush do ta mendonte se pas kësaj vuajtjeje... unë do ta takoja Papën!”

Me rastin e festës së Zojës Nunciatë, më 25 mars 2017, bashkësia katolike e famullisë së Shën Kollit të Pistullit, u mbledh për ta nderuar Motren me kërkesën e Kuries dioqezane të Sapës, Ati i Shenjtë Papa Françesku e nderoi me medaljen e Kryqit të artë “Pro ecclesia et pontifice”.

Me 08 dhjetor 2018, Bashkia e Vau Dejes i dha titullin e nderit, si dhe shkolla në Pistull mbanë emrin e saj.

Së fundi, pasurinë që Motër Maria kishte e qe na lenë edhe neve sot janë virtytet e saja: thjeshtësia, përvujtëria, sakrifica, dëgjësia, lutja, dashuria e pandashme për Zotin dhe njerëzit.

Me jetën e saj fitoi shumë zemra që sot e nderojnë, gati si për ta shpallur shenjtëreshë të gjallë mes nesh.

Lutja që formuloi mt Maria si përmbledhje e dëshmisë së Motrave:

O Zot i jetës dhe i të Mirës, sa të kemi dashur, dëshiruar dhe adhuruar në fshehtësinë e shtëpive dhe të zemrave tona. Të falënderojmë për këtë aventurë tragjike, pasi kemi pasur mundësi që të të kishim ndër duart tona, në vend të Meshtarëve të torturuar apo të dënuar me vdekje. Të lëvdojmë pasi si Stigmatine të kemi ruajtur në shtëpitë tona të thjeshta, mes teshave tona; kemi sfiduar policinë për të të çuar Ty te të sëmurët, te Motrat që po të prinin; të kemi çuar në spitale, në errësinën e burgjeve, duke u ndeshur me rreziqe të mëdha. Faleminderit, o Zot Jezus! Qëndro gjithmonë me ne, o Bukë e jetës së pasosur!”

Me datën 02. 01. 2022 Mt Maria ndërroi jetë në

moshën 92 vjeçare, në Kunvendin e Motrave Shkodër. Ceremonia e homazheve ju bë në fshatin Pitull ku ajo ka jetuar rreth 75 vite me familjen e saj. Në orën 16:00 masdreke u kremtua Mesha e Shenjt nga Imzot Simon Kulli, ipeshkëv i Sapës dhe me pas u shoqërua më një kortezh të gjatë me makina nga banorët e vendit, për në Kishën e Motrave Stigmatine Shkodër, ku vazhduan lutjet dhe homazhet.


Me datën 03. 01. 2022, u celebra Mesha e salikimit nga Imzot Angelo Massafra Arqipeshkëv Shkodër-Pult, bashkëkremtuan edhe Imzot Simon Kulli, Imzot Gjergj Meta dhe shumë meshtarë. E pranishme ishte zëvendësja e Eprorës së Përgjithshme M. Dukata Radoja, autoritete civile z. Zef Hila, rregulltarë e besimtarë të ardhur nga vende të ndryshme. Ngushëllimet dhe telegramet kanë ardhur nga Nunci Apostolik në Shqipëri, Sh. e Tij Imzot Luigi Bonazzi, Eprorja e Përgjithshme e Institutit të Motrave Stigmatine, M. Encarna Lobato, Sr. Chiara Pieri ish missionare e delegate në Shqipëri e shumë tjera.

Mt Maria u përcoll me nderim e thjeshtësi tek varrezat e Rrmajt ku trupi i saj pushon në varrin e Motrave Stigmatine, ashtu siç ajo e kishte lërë në porosi:

Faleminderit Moter Maria që qëndrove në fe në Hyjin, për atë që i dhurove Kishës, Motrave Stigmatine, besimtarëve ku ke shërbyer, meshtarëve, të sëmurëve dhe të vetmuarve, jeta jote mbetet e gjallë në mes nesh. Pushosh në lumnin e Atit qiellor.

Motër, Terezina Demaj

Shkodër, 03. 01. 2022



TË MBULUAR ME “PLLAKËN E RËNDË TË HARRESËS” PËR DEKADA E SHEKUJ!

Roli i Gazullorëve si klerikë, shkencëtarë, diplomate dhe atdhetarë është i spikatur për 5 shekuj, që nga shekulli 15 deri 20.

Në Dajç të Zadrimës, me dt. 30 dhjetor 2021, me pjesëmarrjen e krerëve të klerit katolik, historianë dhe studiues nga Akademia e Shkencave, autoritete lokale dhe shumë banorë të zonës, u bë përrurimi i memorialit të klerikëve, Gjon dhe Pal Gazulli, shek.. XV, Nikollë dhe Gjon Gazulli (i riu) të shek. XX e dhe klerikëve të tjerë.

I harruan i varën, i vranë, e i mohuan dhe këta burra të fisit e të rrënjëve të thella të trungut Gazulli -- ndër më fisnikët e kombit -- gazullorët e Shqipërisë dhe të Kombit shqiptar, të cilët gjatë shekujve i kanë dhënë aq shumë, jo vetëm Kombit shqiptar, në fushë të ndryshme të shkencës e diplomacisë, por edhe qytetërimit



evropian, më idealin e tyre " Për Fë e Atdhe e Përparim".

Ideatorët dhe projektuesit e ndërtimit të Përkujtimores, Dom Angjelin Krygja, Dom Nikë Ukgjini dhe Zef Ndreca, shprehen tejet të kënaqur, që u arrit me ndihmën e banorëve, brenda dhe në mërgim, në veçanti, dashamirësve të tjerë, si: Viktor Jushi, e Pren Gjoka, Ndoc Bardhok Gjoka, Sokol Gazulli, të përfundoi, për gjatë katër muajsh e gjithë kjo vepër, madhështore, kushtuar klerikëve Gazullorë gjatë Shekujve.

Sipas skulptorit Sadik Spahia, ky është një monument mbarëkombëtar që formën e një biblioteke simbolizon njerëzit më të shquar të Shqipërisë në shekuj të fisit gazullor. E gjithë platforma e ndërtuar, nënkupton thellësinë në shekuj dhe diturinë e këtyre njerëzve të shquar.

“Një shtet dhe një komb që nuk kujton figurat historike të identitetit kombëtar, do të zhduket”, do thoshte, Abraham Linkoln, burrështetasin, Amerikan.

Redaksia






Dom Anton Kçira

KUJTIME DHE PËRJETIME


Botime Shkodra
Shkodër 2021



Marcus Aurelius

MEDITIME

Minerva, Tiranë 2021



Ernesto Cozzi

Fra i Monti D'Albania

Harrassowitz Verlag
Wiesbaden - 2021

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në eleven studio - www.11stud.io